

21.08.2024

Ora, 12:05

**RENDI I DITËS**

“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.11 datë 9 gusht 2024, depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt “Kundërshtimi i vendimit nr.85, datë 5.08.2024, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Himarë”, në zgjedhjet e pjeshme të datës 4.08.2024 të KZAZ-së nr.88”.

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali (online),  
z. K. Bele, z. L. Braho
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, z. E. Meta, z. M. Bardhi
- **Parti Politike:** Z.F. Nuri (BF), z.V.Dule (PBDNJ), z.E.Salianji (PS)
- **Të tjerë:** **KRIIK**

**Z. K. Bele:** Përshëndetje! Çelim seancën, për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr.11, me ankues Koalicionin “Bashkë Fitojmë”, me objekt ankimi: “Kundërshtimin e vendimit nr.85, datë 05.08.2024, të KZAZ-së nr.88 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë”, në zgjedhjet e pjeshme të datës 04.08.2024. Dy, “Pavlefshmëria e objektit të zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha qendrat e votimit të zonës zgjedhore, Bashkia Himarë”, “Rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore, Bashkia Himarë”. Relatojmë, në seancën paraprake është vendosur kalimi për shqyrtim në themel.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

Gjithashtu është bërë pjesë e këtij shqyrtimi dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe merr pjesë në këtë shqyrtim. Relatohet prezenca e KAS me katër anëtarë, si dhe anëtari i pestë është prezent, është në lidhje në rrugë elektronike (online), z.Rusmali. Gjithashtu kemi prezent administratën e KQZ-së, përfaqësuar nga?

**Z. M. Bardhi:** Z. Marisold Bardhi, me autorizim.

**Z. K. Bele:** Po dhe stafi teknik. Prezent në sallë kemi përfaqësues të ankuesit?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Z. Franci Nuri, përfaqësues i “Bashkë Fitojmë”, prezent.

**Z. V. Dule, Kryetar i PBDNJ:** Z. Vangjel Dule, “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”.

**Z. K. Bele:** Relatohet gjithashtu një kërkesë nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, drejtuar KAS-it për të marrë pjesë si palë në shqyrtim, pra si palë e interesuar. Ka depozituar një kërkesë me shkrim duke shpjeguar se ka ardhur në dijeni dhe ka interes të ligjshëm. KAS i konsultuar në vend sipas praktikës së ngjashme në këto shqyrtime administrative vendos pranimin dhe bërjen pjesë dhe të Partisë Socialiste në këtë shqyrtim. Në këtë fazë palët pyetën nëse kanë ndonjë kërkesë paraprake apo ndonjë kërkim lidhur me KAS-in, legjitimimin dhe pjesëmarrjen. Kemi ndonjë gjë? Po. Gjithashtu, krahas kërkesës nga Partia Socialiste është dorëzuar dhe një prokurë për të përfaqësuar z.Vangjel Tavo. Mbajtësi i prokurës ka ndonjë kërkesë nga z. Tavo?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Tani legjitimohet të bëj kërkesë. Pra, paraqitemi me prokurë, se në qoftë se Partia Socialiste është e legjitimuar në proces, hyn një proces administrativ. Vetë kërkesë padia, kërkesa ankimore duhet ta kishte parashtruar, si person ndaj të cilit ishin interesuar ankuesit duhet ta kishin... Është praktikë 10 vjeçare që personi që merr mandatin shënohet në kërkesë ankimore. Ky rast nuk e ka. Megjithatë pasojat, dihet që ky akt sjell pasoja ndaj z.Tavo, shqyrtimi administrativ. Vetë ju, në qoftë se nuk vinte vetë ai, duhet ta njoftoni, që po shqyrtohet një akt ose jo. Megjithatë, kërkojmë të pranoni prokurën pastaj kam të drejtë që ta bëj kërkesën.

**Z. K. Bele:** Pra, ju paraqisni prokurën dhe kërkonit të jeni ...?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Kërkojmë të jemi, përfaqësues të z.Tavo, pjesë e shqyrtimit.

**Z. K. Bele:** Mirë. Z.Rusmali ka ndonjë kërkesë nga ana juaj, ka ndonjë pyetje për këtë moment procedural?

**Z. I. Rusmali:** Jo, unë nuk kam asgjë për të shtuar.

**Z. K. Bele:** Dakord. Të konsultuar në vend, KAS, gjithashtu pranon kërkesën për të legjitimuar dhe për të bërë pjesë të shqyrtimit edhe z.Vangjel Tavo, nëpërmjet përfaqësuesit tij me prokurë, avokat Eridian Salianjin. Vazhdojmë seancën nëse s'ka ndonjë kërkesë tjetër? Po?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Faleminderit! Ajo që ne duam të kërkojmë dhe njëherë sikundër e kërkuam dhe herën e shkuar në seancën jopublike për legjitimimin. Duam t'i bëjmë me dije KAS-it që kemi depozituar një kërkesë për marrjen e informacionit dhe nuk na është vënë në dispozicion deri në këtë moment. Ndoshta, preferojmë ta ngremë në këtë fazë që të jeni në dijeni të kësaj çështje dhe t'i kërkonit KQZ-së marrjen e këtyre provave.

**Z. K. Bele:** Për ta rikujtuar momentin, në datën 12 gusht në seancën paraprake, gjatë diskutimit, midis të tjerash, u parashtrua nevoja dhe kërkimi juaj për prova. U la detyrë nga KAS që kjo kërkesë të parashtrohet me shkrim, drejtuar administratës, konform Kodit të Procedurave Administrative dhe praktikës shumëvjeçare për këtë qëllim. Për ato prova të cilat merren pranë KQZ-së duke dalluar ato prova të cilat merren nga KZAZ-ja, ku pala, subjekti politik, për vetë natyrën e procesit ka disponim të lirshëm dhe ne këtu u ndalëm. Tani, shohim shkresën tuaj dhe janë konkretisht 7 kërkesa, duke i marrë me radhë ato, pra kërkesën nr.1 ose paraprakisht do të pyesim KQZ-në. Çfarë qëndrimi kanë për këto kërkesa? Duke e marrë të mirëqenë atë që thotë z. Nuri, pse nuk janë vënë në dispozicion ato që ka qenë e mundur? Pra, mos ta komplikojmë, se jemi të qartë që kemi qenë në gusht, ka pasur administratë, a ka pasur mundësi? A është vepruar mbi këtë kërkim?

**Z. M. Bardhi:** Për sa i përket kërkesave të parashtruara, nëpërmjet numrit të protokollit 2450, datë 13.08.2024, administrata është vënë në lëvizje dhe ka grumbulluar sa ka pasur mundësi, për pjesën tjetër të mbetur do t'i vëmë në dispozicion në vazhdimësi. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** Në e kuptova drejt, nuk janë dërguar shkresërisht, me email apo formë tjetër? Kemi ndonjë gjë gati, ndërsa ne flasim?

**Z. M. Bardhi:** Atëherë, gati është lista e kandidaturave të Partisë Socialiste, është raporti i auditit...

**Z. K. Bele:** Z.Marisolld i marrim me radhë, keni shkresë përpara?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Nëse duhet t'i relatoj shkurtimisht kërkesat tona, qoftë dhe për moment procedural?

**Z. K. Bele:** E bëjmë bashkë këtë proces. Pra, kërkesa e parë është raporti i auditit teknikien, për problematikën e listave të zgjedhësve, e kemi këtë raport? E kemi një kopje t'ia japim palës?

**Z. E. Çefa:** E ka pala në dispozicion?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Jo, ne nuk e kemi për momentin.

**Z. E. Çefa:** Ta ketë pala, se pala e ka kërkuar.

**Z. K. Bele:** Ata do të punojnë me atë dokument.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Kjo ishte pika e parë. Pika e dytë i nderuar, është raporti i shkruar ose emaili i kompanisë Smartmatic që menaxhon sistemin e pajisjeve PEI, pas përfundimit të zgjedhjeve të Himarës. Këtu kemi

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

kërkuar ecurinë e procesit dhe të identifikimit të zgjedhësve në 36 qendrat e votimit të Bashkisë së Himarës.

**Z. K. Bele:** Është raporti?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Komunikimet me email sepse këtu ne duam të shohim në mënyrë zyrtare, numrin e saktë të zgjedhësve, ku ka pasur problematika me karta ose pasaporta të skaduara. Numrin e saktë të zgjedhësve që mund të kenë pasur problematika gjatë procesit të votimit, ku mund të jetë ndërprerë procesi i votimit. Kërkesa e tretë ka të bëjë me kopjen e të gjithë “Regjistrave të posaçëm”.

**Z. K. Bele:** Më fal, z. Franc, t’i marrim me radhë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, faleminderit!

**Znj. D. Alimemeti:** Në këtë rast Smartmatic nuk ka qenë në menaxhimin e procesit, ata kanë ndihmuar, po si të jashtëm. E kemi bërë ne të gjithë menaxhimin dhe kemi të ngritur ose kemi raporte të cilat mund t’i ndajmë me ju, me pjesën nga sistemi, por nuk ka emaile apo raporte të gjeneruara nga ata sepse po e shikoj e keni të specifikuar, nga Smartmatic.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Pra, nuk ka asnjë raport të shkruar, asnjë komunikim zyrtar me KQZ-në nga ana e kompanisë? Unë nuk e di, ndoshta mund të jetë Smartmatic, ndoshta mund të jetë ndonjë kompani tjetër?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, jo.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Kompania që menaxhon PEI-n.

**Znj. D. Alimemeti:** Ideja është që në fund të procesit gjenerohen të dhënat dhe raportet nxirren nga sistemi, të cilat mund t'ua vëmë në dispozicion.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Mund të na i vini në dispozicion?

**Znj. D. Alimemeti:** Patjetër.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Dakord. Po për momentin ne nuk i kemi në dispozicion dhe kuptova që do na duhet që KAS t'i kërkojë dhe të kemi një kohë të arsyeshme për t'i parë.

**Z. K. Bele:** Sa kohë do të duhet që të gjenerohet kjo?

**Znj. D. Alimemeti:** Unë kam një kopje gati.

**Z. K. Bele:** A është kjo që diskutojmë?

**Znj. D. Alimemeti:** Po, kjo që diskutojmë.

**Z. K. Bele:** Dakord.

**Znj. D. Alimemeti:** Po, kam një kopje gati dhe në qoftë se...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** Po, dakord. Do të na duhet dhe ne, një kopje e atyre akteve. Pra, mund të bëhet një kopje.

**Z. E. Çefa:** Për sqarim, që t'i japim pak seriozitet edhe procesit, nuk mund të pranojmë shprehje të tipit: "I kam një kopje gati". Ligji kërkon një formë të caktuar dokumentacioni, që pala e ka kërkuar dhe ne kemi marrë vendim të ndërmjetëm për t'ua vënë në dispozicion. Tani, do t'ju lutem shumë, t'i përgatisni në formën e kërkuar dhe t'ia dorëzoni, meqenëse s'ia keni dorëzuar deri tani. T'ia dorëzoni këtu, në këtë seancë dhe për atë që keni, për atë që s'keni, pastaj do të shohim mundësinë se si do veprojmë. Po nuk mund të themi "E kam një kopje unë", në qoftë se keni kopje për vete, ne nuk na vlen, ne na duhet kopje zyrtare, për palën dhe për ne, për të gjykuar çështjen më mirë. Kështu që ta them këtë standard dhe të vazhdojmë pastaj. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Pika tre mund të bëhet gati për një kohë të shkurtër. Do i marrim me radhë, pastaj do të marrin një kohë të caktuar që t'i jepet palës dhe të vazhdojmë seancën, për aq sa është e mundur, me ato kërkesa që kemi të realizuara sot. Pika katër, Franci më mirë t'ju dëgjojmë ju çfarë kërkon, që ta vazhdojmë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, faleminderit! Së katërti ne kemi kërkuar nga KQZ-ja në rrugë zyrtare komunikimin e kopjeve të të gjitha procesverbaleve apo dokumentave të tjerë që kanë lidhje me votimin në 36 qendrat e votimit të Bashkisë Himarë, ku mund të jenë të shënuar manualisht identifikimi i mbi 260 votuesve, të cilët kanë pasur probleme me pajisjen PEI sepse kartat e tyre nuk janë njohur për shkak të rinovimit të hershëm. Nga informacioni që kemi

*Zbardhi materialin audio  
Adriano DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

marrë, siç e kemi shpjeguar dhe herën e kaluar, na është bërë e ditur që ekziston një shifër prej rreth 260 zgjedhësish që kanë pasur këtë lloj problematike dhe duam ta dokumentojmë atë, me dokumentat që mund të ketë dhe duhet të ketë patjetër KQZ-ja në dispozicion. Së pesti, po ju bëjmë me dije dhe këto tre të fundit. Kemi kërkuar dokumentacionin që disponon administrata e KQZ-së për shtimin e mbi 360 zgjedhësish të rinj në Himarë, që nga zgjedhjet e vitit të kaluar, të 14 majit 2023. Së gjashti, kemi kërkuar listën e personave të caktuar si komisionerë nga Partia Socialiste, në gjithë Bashkinë e Himarës, në 36 qendrat e votimit, funksionin në administratën publike, vendore apo qendrore, funksionin që mund të kenë pasur.


**Z. K. Bele:** Këtu, te pika gjashtë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, te pika gjashtë.

**Z. K. Bele:** Për komisionerët është një informacion i cili disponohet në KZAZ dhe ju keni pasur gjithë mundësinë kohore. E diskutuam dhe atë ditë, që në KQZ do të kërkohet ai informacion i cili merret në KQZ. Numri i komisionerëve, emrat e tyre dhe çfarëdo lëvizjesh ndodhin në qendrën e votimit ditën e zgjedhjes, në dijeninë time dhe në praktikën shumëvjeçare është një informacion i cili merret dhe administrohet në KZAZ. Ne nuk kemi pse merremi gjatë këtë gjë. KZAZ-ja është e aksesueshme, ka qenë e aksesueshme dhe nuk mendoj që ky është një kërkim që bëhet këtu.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ne këtë kërkesë, për sqarim, e kemi bërë të lidhur edhe me pikën shtatë, ku thelbi nuk janë emrat e personave, por thjesht duam të dimë a kanë pasur funksion publik deri me datën 4 gusht. Pika shtatë, ne

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 21.08.2024*

duam të dimë a kanë marrë autorizim paraprak për të qenë pjesë e procesit zgjedhor? A kanë pasur leje, autorizim paraprak? Ne i jemi drejtuar edhe DAP-it, këtë mund ta them, DAP-i është treguar mjaft korrekt, Departamenti i Administratës Publike, në pjesën e kthimit të përgjigjes. Na ka ardhur një përgjigje nga DAP-i, mbas tre ditësh pasi e kemi kërkuar. Është kjo përgjigja këtu. Departamenti i Administratës Publike na informon se nuk i disponon këto informacione, sepse thelbi që ne kërkojmë është a kanë qenë të pajisur apo jo me autorizim këta persona? DAP-i thotë që ne nuk e disponojmë këtë informacion dhe nuk e kemi kompetencë administrimin e listës dhe na orienton që t'i drejtohem institucioneve të tjera, eprorëve direkt, drejtorive të Burimeve Njerëzore. Pra dhe DAP-i nuk është se na jep një përgjigje shteruese në lidhje me këtë pjesë por nuk na orientonte te KZAZ-ja. Na orienton te institucionet e varësisë ku mund të kenë punuar, ku mund të kenë qenë në marrëdhënie pune këta persona, prandaj dhe ne po e kërkojmë në KQZ. KZAZ-ja varet nga KQZ-ja. KZAZ-ja nuk është më e ngritur në hierarki.

**Z. K. Bele:** Pra, ju kërkon në seancë që ne të marrim listën e personave që kanë qenë në qendër të votimit, të shikojmë ku punojnë, çfarë?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Jo të votimit, të komisionerëve.

**Z. K. Bele:** E kuptoj, pra komisionerët, ku kanë punuar, kanë marrë, s'kanë marrë leje nga vendi i punës dhe këtë do ta bëjmë në këtë seancë! Nuk më duket kërkesë që ngrihet në seancë. Është një informacion që mund të disponohet në nivel KZAZ-je dhe t'i drejtoheshit kujt ju mendoni se do të realizonte këtë kërkesë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 21.08.2024*

Megjithatë jemi në seancë, ju keni kërkesat tuaja. Lidhur me këto kërkesa ka ndonjë qëndrim nga administrata dhe nga palët në proces?

**Z. E. Meta:** Atëherë për sqarim, referuar nenit 37 të Kodit Zgjedhor, nuk është te lista e dokumentave të kërkuara për t'u paraqitur si dokument dhe rrjedhimisht për t'u administruar nga KZAZ-ja dhe nga KQZ-ja. Referuar vendimit nr. 9, ekziston një dispozitë që kërkon që të gjithë anëtarët ose kandidatët për anëtarë që propozohen, t'i drejtohen punëdhënësit të tyre. Në rastin konkret institucionit publik, për t'i bërë ata me dije që do të angazhohen në proceset zgjedhore. Në këtë këndvështrim është marrëdhënia ndërmjet anëtarëve dhe punëdhënësit për të respektuar këtë detyrim. Referuar nenit 37 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.11, nenit 8 të saj, nuk hyn te dokumentat e administruara nga KZAZ-ja dhe rrjedhimisht nga KQZ-ja.

**Z. K. Beke:** Po, e kuptova. Kolegët?

**Z. L. Braho:** Dakord me këtë pjesë. E kemi listën me gjithë anëtarët e qendrave të votimit?

**Z. E. Meta:** Po, listën e kemi, me emra.

**Z. L. Braho:** Mund të na e vini në dispozicion?

**Z. E. Meta:** Po.

**Z. L. Braho:** Edhe palës.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. E. Meta:** Dakord.

**Z. K. Bele:** Ndonjë pyetje tjetër nga kolegët? Mirë, që t'i japim seancës pak rrjedhshmëri dhe mos të ngelemi në këtë moment, unë sugjeroj që të bëjmë një shkëputje të vogël, derisa ato dokumente që ka KQZ-ja, të bëhet një kopje më shumë, të bëhet një fotokopje dhe t'i jepen palës dhe bëjmë një pushim. Kemi ndonjë kërkim apo diçka tjetër, në këtë fazë?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Jo, e vetmja gjë është që këto prova, që nuk po na vihen në dispozicion, t'i kërkojë KAS-i me dy anëtarë, për ato që s'do na vihen në dispozicion.

**Z. K. Bele:** Mirë, ajo është...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Rrjedhimisht do të kërkonim dhe kohë të mjaftueshme që t'i studionim dhe shihnim dokumentet.

**Z. L. Braho:** Pse me dy dhe jo gjithë KAS-i?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Minimalisht me dy, patjetër që me të gjithë...

**Z. E. Çefa:** Z. Nuri me sa shoh unë, këtu nuk ka, të paktën në dukje, nuk ka pengesë dhe nuk ka mosdakordësi dhe nga KQZ-ja për t'i vënë në dispozicion këto, kështu që thjesht është çështje administrimi procesi. KQZ-ja ju lutem, sa

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

kohë ju duhet në dispozicion, që t'i bëni gati në formën e kërkuar nga ligji këto dokumente, këto prova që janë kërkuar? T'ia vini në dispozicion palës dhe më pas ne të... Gjysëm ore, një orë, dy orë, tre ditë? Për 30 minuta? Zoti Nuri sa kohë ju duhet që t'i diskutoni dhe të jeni deri diku të përgatitur për të debatuar mbi ato prova në KAS? Pasi t'i merrni?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Qëndrimi ynë është që duhet të shohim dhe volumin e dokumenteve që janë, t'i marrim në dispozicion, t'i studiojmë. Unë mendoj se një afat prej disa ditësh do të ishte i mjaftueshëm, ndoshta. Nuk e di qëndrimin që mund të ketë dhe pala e interesuar, z.Dule.

**Z. K. Bele:** Më fal, Franci, në kuptimin tonë bëhet fjalë për një tabelë, një listë anëtarësh dhe dokumentacioni i KZAZ-së, pra, raporti i auditit teknikien. Ne kemi marrë tashmë një zgjatje të konsiderueshme dhe duhet të jemi korrekt me procesin se ka dhe afate që janë për ne detyruese, që lidhen me zgjatjen e shqyrtimit administrativ. Sigurisht duhet të mbyllet dhe një proces i caktuar, kështu që bëjmë një shkëputje gjysëm ore. Sugjeroj të marrim dokumentat, ju i shikoni dhe në atë moment shprehemi sa kohë do ju duhet për t'i lexuar, për t'i studiuar, pra mos të flasim apriori.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ju propozoni që të marrim njëherë dokumentat dhe pastaj të shprehemi për kohën e nevojshme?

**Z. K. Bele:** Po, shihini njëherë, mund të jetë ndoshta dhe më e thjeshtë seç e mendojmë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Dakord.

**Z. K. Bele:** Përfaqësuesi i Partisë Socialiste?

**Z. E. Saliqji, përfaqësuesi i PS:** Në fakt, unë s'desha të ndërhyja që në fillim se kjo është një procedurë. Ne sot jemi duke shqyrtuar pavlefshmërinë, kërkesat për zgjedhjet në Bashkinë e Himarë dhe jo duke bërë raportin e zgjedhjeve se çfarë ka ndodhur në Bashkinë Himarë. Pra, pala në kërkim dhe në një proces administrativ duhet që çdo provë duhet ta lidhë se çfarë sjell kjo për pavlefshmërinë, jo çfarë ka ndodhur atje, se ka kaluar një zog në Himarë apo ka ndodhur diçka. Kanë ndodhur shumë gjëra në Himarë, për mirë, mund të ketë pasur edhe ndonjë parregullsi të vogël, por nuk është kjo seanca, nuk është ky raporti, nuk po bëjmë raportin e zgjedhjeve në Himarë që duhen të gjithë këto dokumenta. Për çdo kërkesë që u bë këtu sot para jush duhet ta lidhin me pavlefshmërinë. Ku ndikojnë këto prova në pavlefshmëri? Çfarë duhet ai komisioneri që s'ka marrë autorizimin? Çfarë sjell për pavlefshmërinë? Që s'ka lidhje fare, u sqarua nga administrata. Prova që kërkohet, prova tjetër ku ndikon në pavlefshmëri? 200, që pretendohet, që kanë vajtur 200 persona të cilët nuk kanë marrë atë, te PEI, ku ndikon kjo te paligjshmëria? Pra, çdo kërkesë që bëhet për provën lidhet me shkakun e objektit të padisë, nuk mundet të kërkojmë në hapësirë dhe pastaj pasi kërkojmë në hapësirë kërkojmë dhe kohë për të parë hapësirën! Shqyrtimi administrativ është shumë i qartë, pavlefshmëria dhe Kodi Zgjedhor i ka përcaktuar hapat. Ne mund të vazhdonim me relatimin dhe mbas relatimit të merreshin provat, ne e filluam më gjerë. Dakord thamë për provat, që duhet t'i kishte vetë pala provat, se KZAZ-në në Bashkinë Himarë e kanë drejtuar ankuesit. Shumicën, kryetarin e KZAZ-së në Himarë e kanë pasur ankuesit, që kishin të gjithë mundësinë dhe e kanë mundësinë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

akoma. Kanë pasur shumicë KZAZ-në që të merrnin gjithë dokumentacionin dhe të vinin me një kërkesë të plotë dhe provat nuk mund t'i kërkonin në proces. Megjithatë ju bëtë shumë mirë që do i jepni provat. Le t'i marri provat por nuk mundet që ne mbas marrjes së atyre dokumentave, që s'kanë lidhje fare me pavlefshmërinë, mund t'i duheshin maksimumi ndonjë shoqate për të bërë ndonjë raport se çfarë ka ndodhur, por të vazhdojë shqyrtimin e afatit për të marrë mandatin. Madje jemi në kufijtë e afateve që kandidati fitues duhet të marrë mandatin dhe nuk është gjykim administriv i zakonshëm. Ne këtu jemi, deri sot pasdite duhet të mbylлим dhe të shqyrtohet, vetëm po qe se është ndonjë provë aq e rëndësishme sa këtu të gjithëve do na lërë të shtangur apo ndikon në pavlefshmëri, atëherë hajde e fitojmë kohë.

**Z. K. Bele:** Dakord, e morëm dhe qëndrimin tuaj. Ka ndonjë gjë nga kolegët?

**Z. L. Braho:** Mund ta di z. Salianji, të mos flasim me shifra, këta bëjnë një pretendim. Një nga pretendimet ishte ai përmbi 300 votues që janë futur rishtazi dhe në qoftë se i referohemi kazusit të Rrogozhinës, p.sh që ishte po ashtu problem me regjistrimin e votuesve, pavlefshmëria nuk do të thotë automatikisht rizgjedhje, e ka të përcaktuar Kodi. Në qoftë se shifrat janë të tilla që ndikojnë në rezultat atëherë bëhet një rizgjedhje. Ne mund të konstatojmë pavlefshmëri këtu pa e paragjykuar çështjen, pra për ata 300 votues për mënyrën si janë regjistruar dhe nuk do të ketë rizgjedhje, pra fitues do të jetë z. Tavo. Pretendimi tjetër për 6000 mijë persona që sipas tyre nuk kanë votuar se kanë qenë të skaduara dokumentat e identifikimit. Kjo mund të ndikojë në rizgjedhje. Po kjo mbetet gjithmonë në vlerësim të KAS-it. Pa prova, ne nuk e bëjmë dot këtë, aq më tepër që pala e ka

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

treguar vullnetin që me datë 12 që ka kërkuar provat. Kështu që t'i marrim provat pastaj shqyrtojmë se kush ndikon, kush nuk ndikon dhe sa kohë do i duhen.


**Z. K. Bele:** Mirë, mos të humbasim në debat dhe në diskutim, marrim kohën që thamë, një 30 minutësh, mblidhemi përsëri në orën 13.00 dhe e diskutojmë çfarë është bërë gati. Do ju lutesha, nga administrata se flitet 6000, 6000, ka ndonjë gjë të printuar, një email, një analizë se pse janë 6000? Nga doli kjo shifër? Se e kam dëgjuar në media po nuk e kam kuptuar nga del kjo shifër, shifra 6000? Në qoftë se ka një shpjegim?

**Znj. D. Alimemeti:** Atëherë nga 23074 votues nga lista e zgjedhësve, 6157 ishin persona që ishin me pasaportë jo të vlefshme dhe karta identiteti jo të vlefshme. Ky informacion del nga lista që dërgon DPGJC, do të thotë që në listë ne kemi, pas filtrave të caktuar del ky numër që është ky që po flasim. Ky është rezultati 6157, por në 23000 votues.

**Z. K. Bele:** Jam dakord, por një "screenshot", një email, një letër që të ne ta shikojmë dhe të bindemi. Unë kam shumë respekt për fjalën tuaj, por do doja të kisha një letër, nëse është e mundur. Nëse s'është e mundur, mund të thotë dikush janë 5, dikush janë 7. U tha një shifër, do të donim të kishim një çfarëdo lloj forme të dokumentuar. Tani është gjithçka elektronike por ne kemi filluar punë dhe jemi rritur në kohën që lexonim njëherë një letër. Kështu që do të doja ta shikoja në një letër nëse është, nëse nuk është, mirë? Po?

**Z. M. Bardhi:** Për sa i përket kërkesës nr.4, procesverbalet dhe dokumentat e tjerë janë dokumente që ndodhen në kutinë e votimit.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** Dakord, e qartë. Kopje procesverbali, të dokumentave të votimit ku mund të jetë shënuar manualisht identifikimi i 260 votuesve të cilët pajisja PEI nuk i njihte. Ajo që u kërkua nga përfaqësuesi është, nëse e kuptova drejt, a ka gjeneruar PEI ndonjë raport lidhur me këtë qëllim. Ju thoni që një raport i tillë është në kuti?

**Z. L. Braho:** Këto janë të “Libri i posaçëm”, të “Lista e regjistrit të posaçëm”? Aty janë?

**Z. K. Bele:** Pra, ku gjendet ky dokumentacion, se janë dhe pak teknike këto.


**Z. E. Meta:** Atëherë në lidhje me pikën 4, kopje procesverbali, lista e dokumentave në kutinë e votimit është term i përgjithshëm, në të vërtetë dokumentat e punës së Komisionit të Qendrës së Votimit janë: “Libri i protokollit të mbledhjeve”, ku janë të gjitha llojet e procesverbalet e mundshme që përdoren nga administrata zgjedhore, “Regjisri i posaçëm i zgjedhësve”, teorikisht përdoret vetëm për zgjedhësit që shkojnë të votojnë me vendim gjykate apo anëtarë të administratës zgjedhore.

**Z. L. Braho:** Ka qenë 260, të tillë në zgjedhjet në Himarë?

**Z. K. Bele:** S’e kuptojmë këtë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Një pyetje për administratën e KQZ-së atëherë, nisur nga shpjegimi. Në rast se informacioni që ne na është dhënë është që

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

janë mbajtur shënim manualisht, shënimet manualisht ku mund të mbaheshin përveçse në këto regjistra, te “Regjistri i posaçëm”, procesverbali?

**Z. E. Meta:** Mbahen në “Librin e protokollit të mbledhjeve” sepse “Regjistri i posaçëm” përdoret, jua thashë, vetëm në rastin e zgjedhësve të veçantë, pra që janë me vendim gjyqate, administrata zgjedhore, që nuk janë, që janë në listën e zgjedhësve të zonës zgjedhore por nuk janë në atë qendër votimi.

**Z. K. Bele:** Pyetja është kushtore, ku mund të jenë shënuar?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po pikërisht.

**Z. K. Bele:** Ju vetë keni pasur njerëzit tuaj në terren, duhet ta identifikoni.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Edhe njëherë, në kutinë e votimit, dokumenti mund të gjendet sepse këtu nisi dhe debati?

**Z. E. Meta:** Për sqarim, kutia e votimit ka vetëm dy procesverbale, “Procesverbalin 7” dhe “Procesverbalin 8”, që është i mbylljes së kutisë dhe ai i mbylljes së votimit, dhe fletët e votimit, kutia e votimit. Ndërsa kutia e materialeve zgjedhore përmban gjithë dokumentacionin e punës.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Kjo kërkesë për provë në qoftë se do ishin në formën e kërkuar... Normalisht kërkohet por ka një formë ku thuhet, në fshatin Dhërmi, në këtë qendër votimi, në këtë kuti votimi, në “Librin e protokollit” të kësaj qendre votimi janë 3 persona të shënuar dhe kështu është kërkimi, nuk

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

kërkohet në hapësirë, në gjithë Himarën 206. Pra i thuhet KAS-it që kërkoj të hapet kutia e materialeve zgjedhore ku gjendet “Libri i protokollit i mbledhjeve”, në këtë qendër votimi konkrete, me numër konkret. Të dish çfarë të kërkoj dhe minimumi duke pasur përfaqësues, këtu duhet të kishe një kopje me prova. Çdo parti ka pasur vëzhguesit e vet në qendrën e votimit, të gjithë vëzhguesit kanë mbajtur shënimet e tyre për atë çfarë ka ndodhur në qendrën e votimit, minimumi vihet këtu dhe i thuhet KAS-it. që vëzhguesi i Partisë Demokratike ka konstatuar që në qendrën e votimit në Himarë ose edhe në një fshat, në Borsh, por duke e përcaktuar qartë. Nuk kërkohet në 206, pra mesa kuptova unë kërkuan që të hapen gjithë kutitë e materialeve zgjedhore, kërkohen të merren të gjithë “Librat e protokollit”, kërkohet që t’i lexoni ju të gjithë “Librat e protokollit të mbledhjeve” të KQV-së, t’i gjeni 206, 207 ose 205 dhe pastaj t’i shqyrtoni. Pra, nuk është kjo forma e kërimit, pra për këtë lloj, këtu është problemi, te kërkesa. Në kërkesë, e thashë që në fillim, të kërkohet për pavlefshmërinë. Pse kërkohet të caktohet ku ndodhet prova? Ku ndikon në paligjshmëri?

**Z. L. Braho:** Këtë shifrën 206 apo 260, sa është kjo, tani Franci në qoftë se mund të na e sqarosh, këta janë votues të posaçëm, pra që janë me vendim gjykate apo pjesë e administratës zgjedhore? Apo janë që kanë qenë në listë, kanë rinovuar kartat e identitetit së fundmi, nuk i ka njohur PEI dhe kanë votuar?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Është kjo e dyta. Nga informacionet që ne kemi marrë është kjo e dyta, pra janë votues të regjistruar, kartat i kishin të skaduara, normalisht dhe i kanë rinovuar, një ditë, të premtën, dy ditë para zgjedhjeve. Pajisja PEI nuk ka qenë e përditësuar, softueri, të paktën ky është informacioni që na u dha, për t’i njohur këto karta të rinovuara rishtas.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. L. Braho:** Po pse PEI në listën e zgjedhësve kap vetëm ata që janë me karta të vlefshme?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Këtë nuk di ta them, se çfarë ka PEI, për këtë mund të përgjigjet administrata.

**Z. L. Braho:** Ndoshta administrata e KQZ-së?

**Z. K. Bele:** Pra, nga 6000 e ca thoni ju, këtu duhet t'i zbresim 260, kështu i bie apo jo?

**Znj. D. Alimemeti:** Po, patjetër, unë ju thashë dhe fillimisht, 23074 referohet 6157.


**Z. K. Bele:** Kur e keni bërë këtë kryqëzim, që keni gjetur numrin 6157?

**Znj. D. Alimemeti:** Kjo është bërë kur ka ardhur lista e zgjedhësve për t'u importuar në pajisjet PEI, në datën 25.

**Z. L. Braho:** Pse pajisjet PEI importojnë vetëm ata që kanë dokumenta të vlefshme?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, pajisja PEI ka dhe informacionin për: kush është, kush ka pasaportë të skaduar ose invalide dhe e nxjerr këtë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. L. Braho:** Atëherë mua më skadon karta e identitetit te kjo periudha njëmuajore, para ditës së zgjedhjeve, a e kam emrin në PEI unë?

**Znj. D. Alimemeti:** Patjetër që e keni.

**Z. L. Braho:** Në qoftë se e rinovoj? Po pse këta nuk kanë dalë?

**Z. K. Bele:** PEI e ka të gjithë listën e zgjedhësve të importuar, termi që përdorni ju?

**Znj. D. Alimemeti:** Në datën 15 ne kemi marrë listën e zgjedhësve.

**Z. L. Braho:** 15 korrik?

**Znj. D. Alimemeti:** Në 15 korrik kemi marrë listën përfundimtare të zgjedhësve dhe nga kjo datë ngrihet lista e zgjedhësve. Nga data 15 korrik deri në datën 4 gusht mund të ketë pasur rinovime të kartave të identitetit. Informacioni që hidhet në PEI ka lidhje me dokumentat e gjeneruara deri në atë moment, do të thotë në qoftë se me datë 20...

**Z. L. Braho:** 16.

**Znj. D. Alimemeti:** ...20 keni marrë pasaportën e re, ju mund të shkoni dhe identifikoheni dhe PEI ju thotë që ky person ka një dokument jo të vlefshëm sepse e dhëna që është, nuk është e përditësuar. Domethënë, hapësira nga data e marrjes së listës së zgjedhësve deri në datën e votimit është i pambuluar nga PEI.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** Pyetje, ndoshta teknike, po pse nuk bëhet përditësimi i PEI-it dy ditë para? Po një muaj para?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo sepse është ka proces përgatitor, në bazë të kësaj liste ne përgatisim...

**Z. K. Bele:** Çfarë procesi?

**Znj. D. Alimemeti:** ...në bazë të kësaj liste përgatisim, përgatiten usb-të, përgatiten të gjithë makinat për t'u bërë gati dhe për t'u shpërndarë pastaj në qendrat e votimit. Do të thotë, hapi i parë i përgatitjes është marrja e listës së votimit të zgjedhësve.

**Z. K. Bele:** Dakord, e kuptuam. Po pse duhet të bëhet një muaj para kjo dhe nuk bëhet tre ditë para? Unë s'e kuptoj pse 36 makina dashkan një muaj për të vendosur usb-të, një muaj para?

**Znj. D. Alimemeti:** Sepse procesi ka faza: gjenerohen, shumëfishohen usb-të, bëhet përgatitja, fshirja, përgatitja e pajisjeve dhe një herë nga e para. Nuk është thjesht, marrim një usb dhe e vendosim në pajisje. Pajisja në vetvete ka një procedurë dhe një proces pune i cilën do kohën e vet.

**Z. K. Bele:** Po.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. L. Braho:** Mirë atëherë, supozojmë këta zgjedhës. Çfarë procedure duhet të ndiqni për këta nga ana e KQV-së, në momentin që ai shkon, PEI i thotë që karta apo pasaporta është jo e vlefshme, këto shënohen te “Regjistri i posaçëm” apo nuk shënohen?

**Znj. D. Alimemeti:** Në “Regjistrin e protokollit”, në “Librin e protokollit”.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Në “Regjistrin e posaçëm”, shënohen persona të cilët shkojnë me vendim gjykatë ose...

**Z. L. Braho:** Dakord.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** ...këta e kanë emrin në listën e zgjedhësve dhe është e zgjidhur dhe për këta, s’ka anjë problem. Unë nuk e di, venë me pasaportë, nënshkruajnë te lista e zgjedhësve, votojnë. Kanë shkuar, PEI nuk punon, po e ke emrin në listë, hedhim firmën siç votojmë ne këtu në Tiranë dhe kanë votuar, kaq.

**Z. L. Braho:** Ky proces...

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Ky procesi, atëherë....

**Z. E. Çefa:** Këtë po kërkon pala...

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** ...ky proces, kjo vërteton që këta persona kanë shkuar në qendrën e votimit, kjo vërteton që këta persona i kanë pasur pasaportat, kjo vërteton që këta persona e kanë emrin në listë, kjo vërteton që këta persona

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

kanë votuar! Çfarë? Ku është pavlefshmëria? Se kanë votuar. Thjesht kanë bërë një pit-stop tek...

**Z. K. Bele:** Debatin do ta bëjmë në fund.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** ...pra, nuk është kjo. Pra mund të jetë e PEI-it, e marr të mirëqenë provën, ju e keni që...

**Z. K. Bele:** Z. Salianji këtë e lëmë në fund kur të vijmë te debati.

**Z. L. Braho:** Nuk besoj që KQZ-ja ka nevojë për avokat!

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Unë po shpjegoj ligjin, siç e ka ligji.


**Z. K. Bele:** Dakord.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Kur vete me pasaportë dhe PEI nuk të njeh, shkon dhe voton si gjithë të tjerët, kaq.

**Z. K. Bele:** Mirë, dakord, po do ta lëmë debatin kur të vijmë te provat. Ledio ke pyetje tjetër? Se e lamë një gjysëm ore por po e shtyjmë.

**Z. E. Çefa:** Meqenëse kjo ndikon te gjysëm orëshi, në qoftë se do vënë në dispozicion këto prova për palën, unë nuk e besoj se gjysëm ore mjafton më apo jo? Pra nuk i bëni dot për një gjysëm ore ju këto, “Librat e protokollit”?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** I kanë gati.

**Z. E. Çefa:** A mjafton një gjysëm ore, ta shtyjme prapë dhe tre ditë të tjera? Kaq dua unë të di, vetëm kaq, për efikasitet, për ekonomi të procesit, vetëm kaq, pas gjysëm ore i kemi të gjitha gati këto që të vazhdojmë?

**Z. M. Bardhi:** Siç jua sqarova dhe më sipër janë dokumenta të cilat ndodhen në kutinë e materialeve zgjedhore, po dhe ato hapen me vendim. Kërkesat e tjera po, patjetër për gjysëm ore.


**Z. K. Bele:** Atëherë po mbledhemi në 13.30 që të jemi më eficientë, jemi dakord? Dhe vazhdojmë procesin, ju merrni dokumentat sa më shpejt të jetë e mundur ne vazhdojmë debatin në atë moment. Faleminderit, me kaq e mbyllim.

**Rifillon seanca**

**Ora 13:47**

**Z. K. Bele:** Riçelimi seancën, u ndërpre në momentin procedural të kërimit të disa provave shkresore të kërkuara nga ana e ankuesit, me shkresën e datës 12 gusht. Konkretisht duke i marrë ato me radhë, kemi raportin e audituesit teknikien, lidhur me problematikën e zgjedhësve në Himarë, na është vendosur një kopje përpara, besoj e keni marrë? Megjithatë për të orientuar pak, para se të ecim me debatin për provat, për të orientuar pak diskutimin. Franci, ne kemi disa herë, ndoshta jo në të njëjtën, pak a shumë para kësaj trupe, ku shqyrtimi administrativ nuk është hera e parë që e dëshmojmë me kërkesa, të rasteve të pavlefshmërisë. Sidomos viti 2021, 2023, ka pasur disa raste dhe sjell në vëmendje që praktika në kuptim të ligjit ne

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 21.08.2024*

këtu nuk vijmë për të gjetur shkakun. Shkaqet dhe fabulën, në nivel pretendimi pala ankuese e ka, kërkon të konfirmojë me shifra apo prova, që do provojnë atë çka ajo arsyeton dhe mendoj të biem dakord ne këtu do ta orientojmë debatin. Pra, shkelja e pretenduar, e verifikon shkresa, jo nga shkresa të kërkojmë ... Sepse ashtu krijohet një rreth që nuk i vlen procesit. Megjithatë vijmë te raporti i audituesit teknikien, unë e kam një kopje, me sa shoh e kanë dhe kolegët. Doni t'i debatojmë njëra pas tjetrës apo do ecim njëherë me marrjen?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ne deshëm të shohim a janë, a na janë vënë në dispozicion njëherë të gjitha.


**Z. K. Bele:** Raportin e audituesit e keni?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po e kemi një kopje.

**Z. K. Bele:** Për raportin e kompanisë Smartmatic, kjo e dyta u dha shpjegim nga përfaqësuesja që nuk ka një raport të tillë. Keni ndonjë kërkesë?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Na është vënë në dispozicion tani një material, tabelë, që na u shpjegua se ka lidhje me pikën e dytë. Ndoshta administrata mund të na e shpjegojë më mirë. Megjithatë në vija të përgjithshme, të nderuar, na thanë që pikat 3 dhe pika 4 nuk i kanë. KQZ-ja, administrata e KQZ-së nuk i ka, që janë kopjet e “Regjistrave të posaçëm” dhe kopje e procesverbaleve dhe e dokumentave të tjera të votimit, për atë që relatuam më përpara.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** Më fal, të ezurojmë pikën 2, bëhet fjalë për këtë dokument, këtë tabelë exeli që konsiston në?

**Z. D. Alimemeti:** Është raporti përfundimtar, statistikor i sistemit të identifikimit elektronik, ku përfshihet, të gjithë personat që janë identifikuar. Duke i ndarë pastaj me veçori, me specifika, të verifikuar me gjurmë gishti, pa gjurmë gishti, nga lista e veçantë, kush ka shkuar në një qendër votimi të gabuar dhe pastaj, të gjitha këto janë detaje të përfshira në atë raport.

**Z. K. Bele:** Dakord. Pra kjo, unë shikoj në faqen e dytë që ka të dhënat numerike duke filluar nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve dhe raportimet që ka bërë sistemi, pra në këtë kuptim është ajo çfarë kërkohet në pikën 2 por e gjeneruar nga administrata e KQZ-së, e cila ka menaxhuar sistemin në terma elektronikë. Në këtë kuptim dhe kjo kërkesë e pikës 2 konsiderohet e plotësuar. Vijnë te pika 3, kërkohet kopje e “Regjistrave të posaçëm” të 36 QV-ve në Himarë, ku janë evidentuar 560 zgjedhës që nuk janë lejuar të votojnë pasi karta e identitetit rezultonte me datë të skaduar. Për ngritjen e një pretendimi të tillë, ku mbështeteni përfaqësues?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Sikundër e kemi thënë dhe në herët e kaluara, këtë informacion e kemi marrë nga burimet tona, pranë KZAZ-së dhe nga informacioni në terren. Jo vetëm për këtë por edhe për pjesën e pikës 4, që janë të paktën 260 votues të cilët janë regjistruar në mënyrë manuale, këto dokumenta KQZ-ja na shpjegoi, administrata, se gjenden në kutinë e materialeve zgjedhore. Në këtë rast ne i kërkojmë t’i kemi në dispozicion, në mënyrë që të bëjmë një mbrojtje efektive, të kemi të gjitha provat në dispozicion si në KAS, si në Kolegjin

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

Zgjedhor. Këto gjëra do t'i kërkojnë kështu që unë do kërkoja që këto dy pika që nuk janë ezauruar dhe KQZ-ja nuk na i ka vënë në dispozicion. KAS-i me dispozitën përkatëse të Kodit Zgjedhor ku dy anëtarë mund ta kërkojnë, të paktën dy anëtarë mund ta kërkojnë, unë do kërkoja si përfaqësues i Koalicionit "Bashkë Fitojmë" hapjen e kutive të materiale zgjedhore ku gjenden pikërisht këto elementë sipas orientimit që dha dhe KQZ-ja që këto materiale gjenden në kutinë e materialeve zgjedhore.

**Z. K. Bele:** Para se të vijmë te ky moment, për ta kuptuar pse e kërkojmë, se ne në këtë shqyrtim, seanca e mëparshme nuk ka qenë, janë hapur materialet dhe janë gjetur ato që janë kërkuar pavarësisht se çfarë kanë provuar, por pa e paragjykuar këtu te pika 3 ngrihet një pretendim që janë evidentuar të paktën 560 zgjedhës. Tani, siç e kuptoj unë në komisionin e qendrës së votimit duhet të ketë një shënim për këtë fakt apo jo? Ne nuk mund të ecim me më ka thënë x apo y, në 36 qendra votimi komisionet e qendrave të votimit kanë të drejtën e tyre të lënë shënime në "Librat e protokollit" dhe kemi ndonjë provë të tillë, kemi ndonjë fillim prove?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ne kemi procesverbalin ku është nënshkruar dhe me shënimin përkatës që nuk janë lejuar të votojnë zgjedhësit për shkak të kartave të tyre të skaduara. Pra, është ky procesverbali këtu dhe këtë e kemi diskutuar, që është shënuar, që në momentin, kur është publikuar Tabela e Rezultatit. Mbi bazën e këtyre indicieve dhe indicieve të tjera që KZAZ-ja ka arritur të grumbullojë po kërkojmë marrjen e këtyre provave sepse ne gjykojmë i nderuar, që me këto shifra mund të arrijmë tek rezultati, tek diferenca e rezultatit dhe për të arritur tek ajo që ne kërkojmë, pavlefshmëria dhe përsëritja e zgjedhjeve si pasojë e saj.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** Pra ju mendoni se do kuantifikoni nëpërmjet këtyre numrave të kaloni një vlerë e cila e bën...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Jo votëm me këto numra por edhe me shifrën e mbi 6000 zgjedhësve që ju është mohuar e drejta e votimit, të parimit të sigurisë juridike, si një e drejtë e fituar në zgjedhjet e shkuara, të paktën 3 palë zgjedhje të shkuara në Bashkinë Himarë. Ku qytetarët kanë pasur të njëjtën mundësi të votojnë dhe me kartë të skaduar, kësaj radhe s'është lejuar.

**Z. K. Bele:** Franci, nëse unë e kuptoj drej këta 560 zgjedhës janë pjesë e këtyre 6000 zgjedhësve që ju thoni kanë pasur të drejtën ose kanë pasur, nuk kanë pasur mundësinë të votojnë, për shkak të kartave të votimit.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po edhe një sqarim të vogël, këta 560 zgjedhës...

**Z. K. Bele:** Ky nuk është fakt që e mohon njeri.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** ...këta 560 zgjedhës ose edhe më tepër se kaq, prandaj duhet parë dhe shifra ekzakte. Ne pretendojmë që kanë iniciuar procesin e votimit dhe i është ndërprerë në mes për shkak të kartave të identitetit dhe sinjalit të pajisjes PEI që mund të ketë dhënë aty eventualisht. Por ne kemi dhe indicie të tjera që një pjesë e zgjedhësve mund të kenë votuar në Himarë dhe me karta të skaduar dhe pasaporta të skaduar sepse vendimmarrja mund të jetë marrë në komision aty për aty, në secilin komision të qendrës së votimit. Duke qenë se

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

janë 36 qendra votimi nuk është shifër shumë e lartë në krahasim me bashkitë e tjera që kanë me qindra mijëra zgjedhës dhe shumë qendra votimi në mendojmë që është një kërkesë e arsyeshme që të hapen në këtë moment këto materiale dhe të na vihen në dispozicion, palës dhe ankuesve sepse këtë gjë ne do ta kërkojmë edhe në instancat e tjera, kështu që...

**Z. K. Bele:** Që ta kuptoj drejt, ju thoni dikush ka vajtur me dokument i cili nuk ka qenë i vlefshëm në kuptim të vlefshmërisë, dokument që keni përdorur termin e skaduar dhe nuk është lejuar të votojë. Dikush tjetër thoni mund të ketë vajtur me një dokument të tillë dhe mund të jetë lejuar të votojë, pra ne duhet të marrëm 8000 votuesit dhe t'i kontrollojmë të gjitha ata që kanë hedhur firmat, kush ka dokument, si do realizohet? Se ju nuk keni indicie, ju thoni në një qendër votimi mund të ketë vajtur x dhe janë 560 të tillë me kartë të skaduar, disa prej tyre janë lejuar të votojnë. Tani më fal po kjo është, të kalojmë në nivel nga hipotezë, te hipoteza, te hipoteza, për të vajtur ku? Se pranojmë faktin se 500, 6157 thotë përfaqësuesja e KQZ-së kanë qenë në fazën e parë, ndërkaq del dhe një numër tjetër prej 260 vetash të cilët si duket kanë shfrytëzuar atë periudhë apo nuk e di në çfarë mënyre kanë rinovuar dhe si të tillë janë paraqitur, kanë votuar dhe PEI nuk e ka njohur si të vlefshme por duke që janë zgjedhës është verifikuar në prezencë të një dokumenti dhe kanë votuar. Pra këto fakte nuk refuzohen nga administrata e KQZ-së, korrekt? Nëse ne do të kërkojmë hapjen e këtyre materialeve zgjedhore, çfarë do të marrim veç këtyre fakteve të cilat pranohen si të tilla. E vetmja e re që ju thatë në këtë parashtrim është që ndoshta dikush mund të ketë pasur dokument të skaduar por ka votuar, ne nuk kemi si vemi te kjo hipotezë. Pra, nëse unë e kuptoj drejt fakti që kanë votuar 260 veta dhe nga diskutimi i mëparshëm nuk mohohet dhe drejtori e shpjegoi që kjo është një procedurë që ndodh. Ti ke një

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

kartë e cila ka dalë më pas në periudhën zgjedhore, nga momenti i daljes së listës deri në ditën e zgjedhjeve shtetasit e interesuar për çfarëdo lloj arsyeje u ka ardhur radha të bëjnë rinovimin e dokumentit, e kanë bërë dhe janë 260 të tillë, kjo nuk refuzohet, pra ne nuk mund të shkojmë te kutia për të marrë një gjë e cila na pranohet si e tillë. Ky ishte komenti, nuk e di nëse ka ndonjë gjë për të shtuar kolegët?

**Z. E. Lako:** Në vijim të kësaj që sapo tha relatori, nga pala ankuese mundet të na bëhet një sqarim, ku do arrijmë me këtë hapjen e kutive të materialeve zgjedhore, çfarë do arrijmë? Pasi për t'i bërë një përmbledhje, ka një kazus që flitet që janë 6000 votues me karta të skaduara, nga këta kanë shprehur vullnetin për të votuar rreth 500 e ca votues dhe janë 200 e ca votues që kanë rinovuar dokumentin dhe nuk i ka njohur sistemi PEI, pak a shumë, kjo është përmbledhja. Cili është pretendimi juaj? Që votuesit, këta 6000 nuk ju është pranuar që të rinovohet dokumenti i identifikimit, që votuesit janë intimiduar dhe nuk janë lejuar të votojnë apo që nuk është i rregullt votimi kur nuk e njih pajisja PEI? Sepse po të bëjmë një krahasim dhe me zgjedhje të kaluara jam shumë i sigurtë që pak a shumë ky do jetë numri i personave që u ka skaduar dokumenti, personat që kanë dashur ta rinovojnë dokumentin e kanë kryer. Se siç pranohet dhe nga ju dhe del dhe nga sistemi kanë njerëz që kanë rinovuar dokumentin dhe kanë shkuar të votojnë dhe pavarësisht se nuk ia ka njohur sistemi PEI, ata janë lejuar të votojnë. Pra, cili është pretendimi juaj që të na çojë ne në marrjen e një vendimi për hapjen e kutive dhe çfarë do gjejmë aty? Pak a shumë në këtë diskurs që bëri dhe relatori, po për të bërë një qartësim edhe të opinionit, se këtu thuhet disa shifra, por nuk mbështeten se ku, se çfarë kërkohet të arrihet dhe çfarë ka ndodhur në këto zgjedhje ndryshe nga zgjedhjet e kaluara? Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ne këtë kërkesë e patëm bërë që në fillim të KQZ-ja që të na viheshin në dispozicion “Procesverbalet”, “Regjistrat e posaçëm”. Në fillim u tha që vetëm pika 4, për pikën 4, ndodheshin në kutitë e materialeve zgjedhore, tani na u dha informacioni, pak më përpara që edhe elementët e kërkuar në pikën 3 ndodhen aty. Pra ne nuk po kërkojmë detyrimisht tejzgjatjen e procesit. Ne duam të na vihen në dispozicion ato procesverbale...

**Z. E. Lako:** Më fal z. Nuri.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:**...që ndodhen aty. Po.

**Z. E. Lako:** Në vijim të kësaj që po thoni, ju sapo i treguat disa procesverbale, disa vendime të KQV-ve të ndryshme, i keni dhe në dosje, në atë kuptim që i keni fotokopjet e këtyre dokumentave.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Cilat vendime?

**Z. E. Lako:** Domethënë ju treguat nja dy fotokopje që janë në dosjen e ankimit, që janë vendime të KQV-ve të ndryshme, ku janë evidentuar persona të cilët nuk janë lejuar të votojnë për shkak se u ka skaduar dokumenti i vlefshmërisë apo nuk e di. Në bazë të këtyre pretendimeve që ju keni, ju i keni disa fotokopje dokumentash.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Jo, është...

**Z. E. Lako:** Çfarë kërkonte të gjeni tjetër nga këto materiale?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*


**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** ...konkretisht bëhej fjalë, ajo që tregova bëhej fjalë për dokumentin e KZAZ-së, ku ishte shënuar kontestimi, manualisht është shënuar kontestimi, datë 5 gusht 2024, për pjesën e votuesve që nuk janë lejuar të votohet po në tërësi, kjo ishte. Nuk kishim fotokopje të tjera dokumentash, por edhe po të shohim dhe këtë material që na ka ardhur në dispozicion tani, s'kemi pasur as kohën e mjaftueshme për ta parë sepse na u vu në dispozicion vetëm pak minuta para seancës dhe aty shihen shifra prej 1438 zgjedhës tek tabela e verifikimeve të gabuara, në total apo verifikime pa shenjë, dalin në total, rezultojnë sipas këtij dokumenti 388 zgjedhës. Ajo që ne duam dhe njëherë të sqarojmë dhe të shohim është se e para të verifikojmë a është e saktë ai numri prej 560. Mund të jetë dhe dy herë më i madh mund të jetë dhe më i vogël, të paktën ky është raportimi që na kanë dhënë nga indiciet. E dyta po ashtu dhe për shifrën e 260 votuesve të tjerë që kanë pasur probleme, duam t'i verifikojmë, a është kjo apo jo. Besoj se dhe KAS-i duhet të duhet t'i verifikojë pretendimet tona, janë të bazuara apo jo. Fatkeqsisht këto prova, këto materiale ndodhen, sipas KQZ-së, në kuti.

**Z. E. Lako:** Po pra, do të shqyrtojmë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ne nuk i disponojmë.

**Z. E. Lako:** KAS-it i intereson dhe ju gjëra që kanë të bëjnë me atë çështje me ato objekt që ne po shqyrtojmë sot. Për ta pasur si statistikë mund t'i interesojë vetë KQZ-së dhe mund të bëjë një proces të mëvonshëm. Ne na intereson çfarë thotë ligji për pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe na duhen prova që kanë lidhje me

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

pavlefshmërinë e zgjedhjeve, nuk mund të shqyrtojmë sot se si ka funksionuar sistemi PEI apo si mund të ketë pasur ndonjë problem procesi zgjedhor, se çdo proces zgjedhor mund të ketë problemet e veta.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Padiskutim.

**Z. E. Lako:** Domethënë çfarë do arrijmë këtu, kjo është pyetja? Çfarë do arrini ju në qoftë se provohet nga hapja e materialeve zgjedhore se janë 260 persona që nuk kanë votuar me PEI-n? Çfarë do arrini?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Shumë e thjeshtë.

**Z. E. Lako:** Ku e mbështesni?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ajo që ne duam të arrijmë është tek pavlefshmëria dhe pavlefshmëria arrihet sikundër të gjithë e dimë duke parë që votat problematike janë në një balancë të tillë që mund të përmbysin rezultatin ose mund të ndryshonin rezultatin, kështu që ne këtu duam të arrijmë, është shumë e qartë, prandaj duam të na vihen në dispozicion këto materiale që t'i analizojmë. A janë realisht 560?

**Z. E. Lako:** Si thoni dhe pretendoni që janë 260 persona që kanë votuar e kanë pasur emrin në listën e zgjedhësve po nuk i ka njohur sistemi PEI. Ky sipas jush pretendohet se është proces i parregullt dhe mund të çojë në pavlefshmëri apo e doni për statistikë? Nëse ju mendoni se është i parregullt ku e mbështesni që

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

personat që nuk votojnë me sistemin PEI nuk ju llogaritet vota apo është votim i paligjshëm. Na e referoni dhe pastaj ne të bëjmë vlerësimin.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Patjetër që nuk e duam për statistikë. Ne nuk jemi këtu për të bërë statistika ne kërkojmë për shkak të diferencës midis dy kandidatëve dhe për të vlerësuar a ka mjaftuar kjo diferencë për të shpallur zgjedhjet e pavlefshme, kjo besoj do ta gjykojë dhe KAS-i por pa na dhënë prova në dispozicion, as ne dhe as ju jemi në këtë fazë. Gjithsesi unë gjej rastin sërish...

**Z. K. Bele:** Më falni, të plotësoj pyetjen, ajo që tha dhe siç e kuptova unë drejt dhe të njëjtën gjë u mundova dhe unë të artikuloj, e marrim të mirëqenë që janë 250 të tillë, po të doni i themi dhe 500, po bëjmë një supozim logjik, ku konsiston shkelja e ligjit, e cila këto vota do mund t'i bënte të pavlefshme? Pra ka ndodhur ky fakt, ne mund të themi që unë pranoj për qëllime të arsytimit që mundet që zgjedhës të caktuar kanë vajtur, s'ka punuar pajisja PEI, kujtomë që në zgjedhjet e kaluara në qendra të caktuara të votimit pajisja PEI dhe nuk ka funksionuar fare dhe është kaluar për tek votimi manual, për shkaqe të ndryshme, të defekteve. Ka qenë një numër relativisht i madh në zgjedhjet e 2023 ku pajisja PEI nuk punoi fare dhe zgjedhjet u zhvilluan me ose pa pajisjen PEI. Ajo është një element që ndikon identifikimin, pra nuk thelbi i zgjedhjeve pajisja PEI. Janë bërë zgjedhje para pajisjes PEI, mund të hiqet fare nesër, ne nuk e dimë. Ajo një formë identifikimi, krahas identifikimit që bën Komisioni i Qendrës së Votimit është dhe kjo pajisje që u mësua të gjithë tani se s'ia dimë emrin e gjatë, që i themi pajisja PEI. Ndodh që shtetasi ka vajtur, pajisja nuk e ka njohur, i kanë verifikuar dokumentin e identifikimit, emri në fletën e votimit, ka firmosur dhe ka votuar. Ku konsiston shkelja këtu, nëse janë 200 apo 2000 të tillë?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Shkeljet mund të jenë të dyanshme këtu, e para mund të jetë eventualisht, po marrim pikën e parë, 560 zgjedhës, të paktën të 560 zgjedhës, të cilëve u është ndërprerë procesi i votimit, ata kanë shkuar me...

**Z. K. Bele:** Kjo është tjetër fabul, të lutem, bëhemi seriozë...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po t'i marrim me radhë, do dal dhe këtu...

**Z. K. Bele:** 560 janë ata të cilët nuk kanë pasur dokument të vlefshëm atë ditë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:**...dhe shkelja...

**Z. K. Bele:** Kjo është pjesa që konstatojmë dhe ligjërisht, të kenë një dokument të vlefshëm, e keni trajtuar dhe ju në ankim, kësaj radhe u zgjat, kësaj radhe nuk u zgjat.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, është e vërtetë.

**Z. K. Bele:** Dakord, vazhdo.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Do vij dhe te pika tjetër, t'i logjikojmë të dyja. Ajo që ne pretendojmë është që e ka penguar dhe e provojmë që të paktën 560 ose ndoshta dhe më tepër janë penguar ditën e zgjedhjeve të votojnë, për këtë fakt nga 6157 persona me karta të skaduara në total. Për mua kjo shifër mund të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

jetë më e madhe por eventualisht nga informacioni që hapën ditën e zgjedhjeve që po pengoheshin të votonin, janë stepur dhe janë një numër më i madh votuesish që nuk kanë vajtur fare të paraqiten dhe nuk e kanë iniciuar procesin e votimit, pra nuk e kanë çekuar fare kartën sepse i kanë thënë ata që janë kthyer që mos shkoni fare se s'po lejohet të votohet ndryshe nga herët e tjera, ky është elementi i parë. Elementi i dytë....

**Z. K. Bele:** Më fal, nuk janë lejuar çfarë?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:**...prej 560, kanë votuar.

**Z. K. Bele:** Kush i ka penguar ata?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Në tre palë zgjedhje të tjera kanë votuar me karta të skaduara apo jo? Sepse është zgjatur me vendim qeverie, me akt.

**Z. K. Bele:** Po, ka pasur një akt, një vendim të Këshillit të ministrave për ndryshim ligjor, i cili ka lejuar që ata të votojnë në një moment të caktuar, kjo është bisedë tjetër, në jemi tek aktiviteti i KQV-ve atë ditë. Pra, komisionet e qendrave të votimit kur qytetari ka vajtur me një dokument i cili atë ditë nuk ishte i vlefshëm, kanë penguar njeri?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Këtë duam të eidentojmë, sepse...

**Z. K. Bele:** T'i marrim me radhë. Ju thoni janë penguar. Çdo me thënë janë penguar? Ai ka vajtur me një dokument, personi është lejuar të votojë, ku qëndron

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

pengimi? Se nëse ka pengim, do të thotë ka shkelje ligji, për t'u identifikuar, mbase bëhet edhe kallëzim penal. Tani mos të bëjmë lojra fjalësh, ju e parashtroni dhe në ankim, e thatë dhe këtu dhe rrjedhimisht dhe të tjerë ka pasur akte rregullatore të cilat i kanë lejuar, këtë vit nuk ka pasur akte rregullator për të votuar dhe ky është fakt publik, i debatuar, nuk pse fshihemi pas gishtit. Nuk jemi ne KAS-i që duhet të vlerësojmë duhej apo nuk duhej një akt i tillë, është bisedë tjetër, çështja është këta shtetas 560 apo 6000 të tillë, këta shtetas mund të votonin me një dokument sipas kuadrit ligjor në fuqi?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ne kemi informacione që ka pasur disa raste që kanë votuar edhe me dokument të skaduar, po ky është ndoshta debat tjetër, po thelbi i kërkesës sonë është çfarë duam ne të demostrojmë.

**Z. K. Bele:** I kemi këto kontestestime z.Nuri. Këta shtetas mund të votonin me këto dokumenta apo jo?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Në zgjedhjet e kaluara, kanë votuar nuk diskutohet sepse është shtuar vlefshmëria dhe kësaj radhe i është cënuar siguria juridike dhe nuk janë lejuar të votojnë. Ajo që desha ...

**Z. K. Bele:** Nuk janë lejuar të votojnë se s'ka pasur akt ligjor që t'i lejonte të votonin. Kaq.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:**...ajo që desha unë të shtoj, thjesht për të mbyllur fjalinë, është që ne pretendojmë që është shkelur barazia e votës, ka pasur

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

raste që janë lejuar të votojnë, ka pasur raste që nuk janë lejuar të votojnë. Ndoshta dhe z. Dule mund të japë shpjegimet e tij në lidhje me rastin.

**Z. L. Braho:** Para se të shkojmë te z. Dule. Z. Nuri ka disa shifra këtu që është kjo shifra 388 që del nga raporti, që janë verifikimet pa shenja gishti, ku besoj përfshihen dhe këtu 122 që janë komisioner apo jo? Janë më vete, pra shifra nuk është 256 është 388.

**Znj. D. Alimemeti:** Në identifikimin në një QV të caktuar ndahen në dy, ose me gjurmë gishti procesi i verifikimit ose pa gjurmë gishti. Në momentin që nuk arrin të lexohet gjurma e gishtit. Kjo është ndarja thelbësore, pastaj pjesa tjetër çfarë kemi, janë specifika të veçanta të tipit, lista e zgjedhësve të veçantë.

**Z. L. Braho:** Po, këto i kuptova, ok. Ka pasur raste që votuesi ka pasur një dokument të vlefshëm përpara këtij 15 ditori, po që sipas sistemit ishte i pavlefshëm. Ka pasur raste të tilla? Në qoftë se z. Nuri mund të më japë përgjigje. Keni indicie për raste të tilla? Pra, një kartë identiteti e lëshuar më parë në kohë, por që sipas sistemit dilte e pavlefshme?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Faleminderit për pyetjen. Janë dhe dokumente që ka sjellë vetë KQZ-ja në dispozicion. Ky dokument këtu që sapo na u vu në dispozicion me nr. protokolli 2243/2 i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Çfarë thotë? Këtu lë të kuptohet që janë të paktën 265 persona që janë identifikuar në PEI dhe sipas të dhënave të Gjendjes Civile dalin se dokumentet ishin të pavlefshme, janë identifikuar ndërkohë që dokumentat dilnin

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

të pavlefshme sipas Gjendjes Civile. Tani ne dhe ju nuk e dimë se da mund të jenë kthyer mbrapsht atë ditë.

**Z. K. Bele:** Cili dokument është ky?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ky, i Gjendjes Civile.

**Z. K. Bele:** 222...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ka një numër të caktuar...

**Znj. D. Alimemeti:** Mund të bëj një sqarim të lutem për dokumentin?

**Z. K. Bele:** Ky është i datës 02.08.24?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, 02.08.24, pra ka një indicie.

**Z. K. Bele:** Para zgjedhjeve?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Dy ditë para, pra ka një indicie në vlerësimin tonë, me aq sa unë i lexoj këto dhe aq sa po arrij të kuptoj tani me një kohë shumë të shkurtër dhe nuk është se patëm kohën që të analizojmë të gjitha elementët, që ka pasur që kanë votuar. Ndërkohë që dilte sipas Gjendjes Civile që dilnin me kartat, pasaportën e skaduar. Atëherë në këtë rast për t'iu kthyer te pyetja juaj e mëparshme a kishin të drejtë të votonin apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** Më fal se mos kemi dokumenta të ndryshëm, 2243/2, datë 2.08.2024?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Kjo është për transferimet.

**Z. K. Bele:** Ti flet për këto?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Megjithatë mund të na e shpjegojë dhe KQZ-ja, administrata se çfarë dokumentash janë. Po edhe njëherë se ne kemi hyrë debatit të provave ndërkohë që jemi te pjesa s'i kemi marrë të gjitha provat dhe s'kemi pasur as kohën e mjaftueshme t'i analizojmë të gjitha, ndoshta po t'i kishim marrë gjërat me radhë. Megjithatë z. Dule, nuk e di çfarë kishe për të shtuar?

**Z. V. Dule:** Faleminderit! Pikërisht këtë do dëshiroja të theksoja se ne jemi duke kërkuar që të na vihen në dispozicion konform legjislacionit provat, jo të diskutojmë thelbin e provave aktualisht. Unë do të dëshiroja të vija në vëmendjen tuaj një fakt, të zbatimit të standardeve të dyfishta. Ekspertja e KQZ-së na tha se votuan qytetarë me karta identiteti që nuk kishin hyrë në fuqi, në sistem sepse kështu parashikohet në bazë të etapave sipas ligjit. Një dokument pra që hyn në fuqi pas dy ditësh është i pavlefshëm dhe po aq i pavlefshëm sa një dokument që ka humbur vlerën para dy ditësh. Pra, ne nuk kemi ardhur që t'ju japim tërësinë e vjedhjes në Himarë për të bërë bilancin, ne kemi ardhur për t'ju thënë dhe për të gjetur përmasat e cënimit të procesit bashkarisht dhe pavlefshmërinë e tij. Është njësoj sikur të gjesh safe-n e bankës së hapur dhe të kërkosh të bësh vlerësimin e dëmit pa bërë numërimet e caktuara, pra është e domosdoshme të na vihet në dispozicion provat që kërkohen prej nesh për të parë dimensionin e cënimit të procesit që shkon me proces logjik dhe më pas edhe matematik në pavlefshmërinë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

e këtij procesi. Po pa vajtur në një konkluzion logjik nuk mund të vemi te ai matematik.

**Z. K. Bele:** Vetëm një gjë, jo për debat po ajo që tha përfaqësuesja e KQZ-së, në qoftë se unë e kam kuptuar drejt. Dua të sqaroj dhe unë, të ndihem vetë i sqaruar. U fol për kartat të cilat ditën e zgjedhjeve ishin të lëshuara deri një ditë para zgjedhjeve, apo ditën e zgjedhjeve dhe ishin të vlefshme sepse vlefshmëria e kartës përcaktohet nga ajo çfarë shkruan ajo, karta vetë, dokumenti, pasaportë apo ID dhe që si të tilla nuk ishin akoma të hedhura në pajisjen PEI sepse pajisja PEI përditësohet ose mbushet me informacion, që ta them në gjuhën që unë e kuptoj një muaj para zgjedhjeve dhe ata që marrin karta gjatë atij muaji nuk dalin si të tillë në pajisjen PEI, por pajisja PEI ka listën e votuesve. Jam korrekt? Dakord.

**Z. L. Braho:** Kam një pyetje për administratën e KQZ-së, nga informacioni që ju kanë sjellë Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile përpara datës së zgjedhjeve, pra kur keni parë këto kryqëzimet sa ishin me dokumenta të vlefshme, nga 23074 zgjedhës, sa zgjedhës janë raportuar nga kjo Drejtori si me pasaporta të vlefshme?

**Znj. D. Alimemeti:** Nuk ka një raport të tillë, jepet databaza fillestare, ku përfshihen të gjitha listat e personave, listat e zgjedhësve. Fillimisht jepet vetëm informacioni i përgjithshëm dhe llojet e listave të zgjedhësve që përdoren për të shpërndarë në QV, më pas vjen lista e zgjedhësve që ka informacion të detajuar mbi vlefshmërinë apo jo të kartave të identitetit dhe pasaportave.

**Z. L. Braho:** Po, këtë listë ose këtë informacion e kemi ne, kur e ka marrë KQZ-ja, si kanë qenë statistikat?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Znj. D. Alimemeti:** Me 25 korrik e kemi marrë këtë informacion. Ka ardhur me 24 ose 25 ka ardhur lista nga...

**Z. L. Braho:** Si kanë qenë raportet, përqindjet e pasaportave të vlefshme në 23000 zgjedhës?

**Znj. D. Alimemeti:** Në 23000 kanë qenë 6157 persona të cilët nuk kanë as kartat e identitetit as pasaporta. Kemi përqindje, mund t'i ndajmë me ju, tani s'dua të bëj gabime në shifra po kam të specifikuar dhe sa janë vetëm me pasaporta të vlefshme dhe sa janë me karta identiteti të vlefshme dhe të gjitha statistikat.

**Z. L. Braho:** Nga informacionet që keni keni ju nga dita e zgjedhjeve, keni pasur raste kur qytetarë, votues me dokumenta identifikimi të vlefshëm dhe që ishte lëshuar nga viti 2023 apo më parë dilnin sipas sistemit të pavlefshme?

**Znj. D. Alimemeti:** Raste të tilla nuk di, kohën, afatin, kur ka qenë vlefshmëria e dokumentit. Kemi të raportuar një ose dy raste të tilla, por ka qenë një problem i leximit të dokumentit, ku mrz-ja e pasaportës është lexuar, në vend të 0 (zero) është lexuar O dhe kjo ka bërë të që ajo verifikohet më mbrapa. Nuk është se në momentin që është dokumenti i identifikimit, ai prevalon mbi sistemin PEI. U kemi operatorëve, prevalon dhe pastaj vazhdoni vendimmarrjen në komision.

**Z. L. Braho:** Një pyetje tjetër që kam ka të bëjë me këtë dokumentin PEI që na keni dhënë sot që ka të bëjë me verifikime të gabuara dhe janë 1438. Çfarë kuptoni me këtë, çfarë do të thotë kjo?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Znj. D. Alimemeti:** Janë persona të cilat kanë shkuar në qendrën e gabuar. Le të themi unë jam 49 në listën e zgjedhësve 4560, në listën e zgjedhësve kam shkuar, kam shkuar te 4560/1. Ky është numri që i referohen ato të dhëna.

**Z. L. Braho:** Dakord.

**Z. K. Bele:** Mirë, vazhdojmë.

**Z. V. Dule:** Më falni se sapo na u vu në dispozicion nga KQZ-ja pikërisht fakti që kërkohet. Kemi qytetarin me pasaportën, në rastin konkret të vlefshëm deri 2026, ndërsa nuk lejohet që të votojë, me pasaportë të vlefshme viti 2026.

**Z. K. Bele:** Në çfarë faqe është ky dokumenti?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Një kopje mund t'ia vini në dispozicion.

**Z. K. Bele:** A po citoni 2450/1?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po 2450/1.

**Z. K. Bele:** Komunikimet e Smartmatic-ut deri në atë kohë. Tani janë disa pasaporta personash.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Deri tani na u tha se s'kishte.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Znj. D. Alimemeti:** Menaxhimi, raporti përfundimtar dhe menaxhimi është bërë nga pala jonë. Kompania ka dhënë suportin e vet dhe kanë qenë pjesë e ndihmës që kanë dhënë gjatë procesit të përgatitjes dhe kanë dhënë ndihmën e tyre, por raportet përfundimtare, rezultatet sigurisht që i kemi të menaxhuar ne nga sistemi.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ne nuk kemi gjë me kompaninë, ne te kërkesa...

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, jo, po ju them që raporti përfundimtar, ajo çfarë kam thënë...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Zonjë te kërkesa jonë zyrtare ne kërkuam dhe emailet, shprehimisht raportin e shkruar ose email të kompanisë Smartmatic.

**Znj. D. Alimemeti:** Po, e qartë, nuk i kam ato.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ne shohim se këtu ka email të Smartmatic. Unë shoh këtu një zotëri @smartmatic.com.

**Znj. D. Alimemeti:** Jam shumë dakord.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Komunikimin me KQZ-në kërkuam, nuk kërkuam komunikime të brendshme të Smartmatic midis tyre, po...

**Znj. D. Alimemeti:** Ju lutem shikoni...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** ...këto të paktën na u vunë në dispozicion tani.

**Znj. D. Alimemeti:** ...po ju them që raporti përfundimtar, ajo çfarë ne gjenerojmë, e gjenerojmë nga sistemi, si ne, si ta gjenerojë Smartmatic i njëjti rezultat është. Do të thotë që unë ato ju dhashë, raporti përfundimtar, ky që keni në dorë është përmbledhje e të gjithë. Ky është informacioni.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po përveç asaj në sqarim, dokumenti nuk përmban vetëm raportin e Smartmatic po mbrapa ka dhe emrat e personave që mund të kenë pasur, disa persona që mund të kenë probleme me identifikimin. Si na i shpjegoni atëherë këta emra? Se s'duam t'i përmendim për shkak privatësie këtu.

**Znj. D. Alimemeti:** Informacioni që ju kërkuat ishte një raport përfundimtar që jep të dhënat, ndërkohë që të dhënat që jep sistemi mund të gjenerojë të dhëna të tjera të plota, por që kanë informacion mbi të dhënat personale që unë nuk mund t'i ndaj ose t'i jap. Këto janë të dhëna statistikore që mund t'ju referojmë dhe mund t'ju japim.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ata janë emra konkret, kur del që "validity ID card", janë pa kartë dhe pa pasaportë të vlefshme. Në fund të emailit. Unë kështu e shoh, të paktën me kaq pak kohë sa kemi në dispozicion, ndërkohë këtu kemi dhe kopjen, kartën apo pasaportën, që dukshëm janë të vlefshme,

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

vlefshmëria është 2025, vlefshmëria 2029, vlefshmëria e kartës së zotërisë tjetër 2032, vlefshmëria 2026 e me radhë.

**Znj. D. Alimemeti:** Pjesa e parë, pjesa e raportit po ju them se si i gjenerojmë ne, si i gjeneron Smartmatic sistemi është një. Informacioni që ju keni në dispozicion është ky informacion. Tani kartat, në qoftë se doni të shkojmë edhe me detaje të tjera, por janë të dhëna personale të qytetarëve dhe unë nuk mund të ndaj me ju këtë pjesë.

**Z. L. Braho:** Dëgjo, ne duam statistika. Ky rasti që ka z. Nuri, në një qendër votimi ka që dalin me dokumente të pavlefshme ndërkohë që janë të vlefshme. Z. Nuri? Një qendër votimi janë këto 5 apo 6 votues që përmendët ju? Që sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile rezultojnë me dokumenta të pavlefshme, ndërkohë që i kanë të vlefshme?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, kështu i bie dhe ky dokument që është i Gjendjes Civile, kjo tabelë exel-i që na u vu në dispozicion dhe këtu dalin.

**Znj. D. Alimemeti:** Nuk është e Gjendjes Civile, është raporti i pajisjes.

**Z. E. Çefa:** Është i pajisjes.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Është i pajisjes, dakord, por ka një numër të konsiderueshëm personash që kanë probleme, sikundër e thamë edhe më përpara por ndoshta nuk është shënuar mjaftueshëm, 388 persona këtu figurojnë në këtë tabelë sipas këtij informacioni që sapo na u vu në dispozicion, me probleme

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

në verifikim, verifikim pa shenja thotë. Në total në fund, është kolona e tretë nga fundi ku thotë verifikimet e gabuara 1438.

**Z. L. Braho:** Këtë e sqaruar.

**Z. K. Bele:** Më fal se këtë e sqaruar, se tani po e lexoj dhe unë. Është sjellë një dokumentacion shtesë nga Nënkomisionerja, e cila ka një email të datës 07.08.24, ju e keni parë, i cili shpjegon këto shifrat e verifikimi që ju e quani, që përdorni termin e gabuar por në fakt është “wrong polling station”, pra personat 1387 qytetarë të ndryshëm kanë qenë në qendrat e votimit të gabuara dhe nga këta 1365 janë verifikuar në mënyrë të suksesshme më vonë. 22 qytetarë që kanë vajtur në qendrën e gabuar nuk kanë vajtur më në qendër tjetër, pra po flasim për një diferencë prej 22 qytetarësh të cilët nuk kanë shkuar për së dyti në qendrën e votimit, këtë thotë ky emaili. Pavarësisht se është në anglisht po është gjuhë shumë e thjeshtë për ta kuptuar. Pra, z.Nuri për ta shpjeguar edhe njëherë këtë shifër që ta shpjegon emaili i Smatmatic-ut, shpjegon që janë 1387 qytetarë që kanë vajtur në qendrën e gabuar dhe nga këta 1365 kanë vajtur në qendrën e saktë, 22 paskan përtuar të venë për së dyti në qendër të votojnë ose nuk janë kapur nga sistemi ose kanë votuar pa PEI në rastin tjetër, këtë s’di ta them. Po, po flasim për numra të vegjël sepse ne kemi parasysh që ky është proces kuantifikues.

**Z. V. Dule:** Si qenkan numra të vegjël?

**Z. K. Bele:** Po janë numra të vegjël sepse në të gjithë...

**Z. V. Dule:** Po pse me miell u mbrujt që qenka numër i vogël?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** Jo, 22 persona.

**Z. V. Dule:** Flasim për votë zotëri, si qenka numër i vogël?

**Z. K. Bele:** Po...

**Z. V. Dule:** Cënimi i një vote si qenka numër i vogël?

**Z. K. Bele:** Atëherë ne jemi në një gjykim pavlefshmërie, nëse ne...

**Z. V. Dule:** Ju verifikoni këto institucione dhe më thoni se është numër i vogël, kalling misri po numërojmë tani?

**Z. K. Bele:** Z. Dule...

**Z. V. Dule:** Po jo tani, më vjen shumë keq!

**Z. K. Bele:**... nuk e kam për t'ju kundërshtuar dhe për të bërë debat...

**Z. V. Dule:** S'është trajtim institucional ky, për një çështje kaq të rëndësishme!

**Z. K. Bele:** ...çështja e pavlefshmërisë është një...

**Z. V. Dule:** S'kemi vajtur, a ka mundësi, ne po diskutojmë kemi të drejtë të marrim këto prova apo s'kemi të drejtë t'i marrim këto prova?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** ...ta kthejmë procesin te debati i provave, dakord.

**Z. V. Dule:** Po sigurisht që aty do ta çojmë se s'është...

**Z. K. Bele:** Dakord, ne bëjmë një diskutim të integruar sepse duhet të kuptojmë ne jemi në një proces administrativ.

**Z. V. Dule:** Jo, ju dëshironi ta bëni, ne jemi në kërkesën tonë për marrjen e provave.

**Z. K. Bele:** Nga ana juaj ishin kërkuar një listë provash dhe ne u munduam ta bënim sa më...

**Z. V. Dule:** Dakord, ose na i jepni ose s'na i jepni, merrni një vendim edhe... S'jemi në kafe!

**Z. K. Bele:** Atëherë për pikën 2 ka ardhur ky informacion shtesë. Për pikën 3 u bë diskutimi lidhur me faktin e regjistrave mos t'i kthehemi përsëri. Lidhur me pikën 3 dhe 4 nga ana juaj u mbajt qëndrimi të hapen kutitë e votimit për të marrë...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Kutitë e materialeve zgjedhore.

**Z. K. Bele:**... ky informacion dhe në fund e përmbledhim. Lidhur me pikën 5 dokumentacioni që disponon administrata e KQZ-së, që tregon shtimin me mbi 360 zgjedhës të rinj në Himarë nga zgjedhjet e 14 majit.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Znj. D. Alimemeti:** Dokumenti që ka ardhur nga DPGJC-ja.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Është dhe raporti i audituesit teknik.

**Z. K. Bele:** Pra është ky?

**Znj. D. Alimemeti:** Së bashku me listën prapa që tregon lëvizjet që kanë ndodhur.

**Z. K. Bele:** Dokumenti që tregon 2243/2?

**Znj. D. Alimemeti:** Po.

**Z. K. Bele:** I protokolluar nga KQZ-ja që ka këtë listën bashkëlidhur. Për pikën 6, listën e personave të caktuar si komisioner nga Partia Socialiste në 36 QV dhe funksionimin të atyre individëve që ishin pjesë e saj deri me datë 4 gusht si dhe dokumentacioni që vërteton se janë të pajisur me leje autorizimi paraprak nga DAP, ku u shpjegua se ky është një dokument që nuk merret në KQZ, nuk ka lidhje me këtë proces.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Na u vu në dispozicion lista e anëtarëve, po e vërtetë.

**Z. K. Bele:** Me kaç, kjo ju thoni, ne e mbyllëm diskutimin me çfarë provash do marrim. Kolegët kanë ndonjë pyetje? Ilir?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. L. Braho:** Vetëm një sqarim sepse këtu debati është me çfarë lloj informacioni i ka servitur Drejtoria e Gjendjes Civile KQZ-së? Pra sa i saktë është informacioni që ka qenë në PEI? Pra kjo shifra 6000 e ca që janë pa kartë identiteti apo shifra rreth 99% që janë pa pasaporta janë të vlefshme, është shifër e saktë apo ka gabime? Sepse në momentin që rezultojnë se ka pasur pasaktësi, në informacionin e hedhur në PEI, atëherë i bie që për votuesit ka qenë vendimmarrje e KQV-së, në qoftë se do votonin apo jo, kur nga sistemi dilte dokumenti i pavlefshëm, thjesht këtë doja, shifrat që ju kanë ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në lidhje me këtë dokumentacion dhe kur KQZ-ja është vënë në dijeni të këtij informacioni? Që pastaj dhe ne të vlerësojmë a duhet t'i hapim materialet zgjedhore për të parë se çfarë shënimesh janë mbajtur në qendra votimi apo jo?

**Znj. D. Alimemeti:** Ky informacion ka ardhur me datë 24 korrik, me listën e zgjedhësve të importuar në pajisjen PEI. Rezultatet ose le të themi kemi bërë kontrollin, ose një konfirmim të të dhënave që ne kemi për të hedhur në pajisjen PEI me DPGJC-në dhe këto shifra janë shifra të sakta deri në momentin që është gjeneruar lista, do të thotë nuk ka pasaktësi, se s'ka se si të ketë pasaktësi në importimin e listës.

**Z. L. Braho:** Atëherë po bëj dhe njëherë pyetjen, sa votues kanë qenë me pasaporta të vlefshme sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile?

**Znj. D. Alimemeti:** Me pasaporta të vlefshme...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Duhet të na e japësh me dokument e jo me fjalë, se po bëhet një pyetje e kemi 3 orë. Po ka dokument na e vër në dispozicion dhe anëtarëve të KAS-it...

**Z. L. Braho:** Dëgjo z. Salianji, mos ndërhy pa leje, ta dëgjojmë përgjigjen pastaj përgjigja besoj se bazohet në një dokument. Unë s'e di se çfarë po lexon po ka dhe pohime këtu...

**Z. K. Bele:** Bëjmë procesin!

**Znj. D. Alimemeti:** Ky informacion gjenerohet nga një listë excel. Listë që e ka gjeneruar Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe ne vetëm filtrojmë të dhëna do të thotë unë nuk mund të jap statistika, mund t'ju them numra, dhe nga 23074 votues, 6157 janë pa ID dhe pa pasaporta të vlefshme. Në ditën e gjenerimit të kësaj, që është data 15 korrik, kjo është data e gjenerimit, kur është sjellë lista dhe kur është stopuar, ngrirë, dhe aty kemi listën përfundimtare. Kjo është përmbledhja, pastaj për të shkuar në detaje, pasaporta të vlefshme, karta të vlefshme, të pavlefshme, unë mund të t'jua jap. Tani unë i kam të dhëna në një...

**Z. L. Braho:** Ato të dhëna që ke thjesht për ta ditur, sa kanë qenë pasaporta të vlefshme.

**Znj. D. Alimemeti:** Pasaporta të vlefshme janë 53 dhe jo të vlefshme janë 23021 dhe ID karta të vlefshme janë 16864 dhe jo të vlefshme janë...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. L. Braho:** Pra, 99% e qytetarëve të Himarës sipas Drejtorisë së Gjendjes Civile janë pa pasaporta të vlefshme, se kështu i bie?

**Z. K. Bele:** Nga doli kjo?

**Z. L. Braho:** Po 52 janë me pasaporta të vlefshme.

**Znj. D. Alimemeti:** 53.

**Z. L. Braho:** 53, nga 23000 .

**Znj. D. Alimemeti:** Sipas listës, ky është informacioni.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Po thoni gjëra që s'kanë logjikë, e kuptoni çfarë po diskutohet këtu apo jo. Këtu po diskutohet, prandaj flisni me letra se dolëm... Më falni ke të drejtë se ndërhyra, se edhe u prish se u bë si muhabet. Pra, pa logjikë fare, të diskutosh që...


**Z. K. Bele:** Një sekond...

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** ...që ata njerëz atje...

**Z. K. Bele:** Eridian ke pyetje?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Kam pyetje, ju lutem na vini në dispozicion këto pohime dokumentacioni, kaq.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. K. Bele:** Po.

**Z. L. Braho:** Tabelën e exel-it vërjani në dispozicion z. Salianji që t'i bëjë vetë filtrat dhe t'i dalë se sa himariotë janë me pasaporta të vlefshme. Shifra mua më duket jorealiste. Nuk e di mbase në Himarë s'ka njeri pasaportë!

**Z. K. Bele:** Tani ju thoni që nga 23000 zgjedhës, 6150 nuk kanë pasur këto dy dokumente?

**Znj. D. Alimemeti:** Po 6157.

**Z. K. Bele:** Po kjo 90 nga doli se s'e kuptova? Se i bie që...


**Znj. D. Alimemeti:** Jo, referencë z. Braho mori vetëm pasaportat, po për të votuar mund të kesh pasaportë dhe kartë identiteti.

**Z. L. Braho:** Mua thjesht nuk më duket te logjika e shifrave sepse dua të dal tek informacioni që ka sjellë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mua nuk më duket realiste që në të gjithë Himarën nga 23000 vetëm 52 paskan pasaportë të vlefshme.

**Z. K. Bele:** E kuptoj, kjo s'ka kuptim, këtu ka një...

**Z. E. Lako:** Ne nuk na intereson kush himariot ka dokument...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. L. Braho:** Po pra në qoftë se është e pasaktë...

**Z. E. Lako:** ...të vlefshëm për të udhëtuar jashtë vendit...

**Z. L. Braho:** Jo, jo në qoftë se Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sjell shifra...

**Z. E. Lako:**...kush himariot ka dokument të vlefshëm për të votuar, jo për të dalë jashtë shtetit...

**Z. L. Braho:** ...dëgjo dalim te...

**Z. E. Lako:** ...një debat që nuk i shërben..

**Z. L. Braho:**...dalim te materialet...

**Z. K. Bele:** Flasim me radhë!

**Z. L. Braho:** ...dalim te materiali tjetër që qytetarët që kanë qenë me pasaporta të vlefshme, në ditën e zgjedhjeve ndërkohë sipas PEI-it dhe sipas Drejtorisë së Gjendjes Civile kanë qenë të pavlefshme, thjesht këtë dua unë të argumentoj se nuk më intereson se sa dalin jashtë shtetit apo jo.

**Z. K. Bele:** Ky është deduksion dhe ne po bëjmë lojra fjalësh, ajo që ne kemi shifër të administruar është shifra e personave, lista e zgjedhësve. Kemi një dokument këtu, të lëshuar nga Komisioneri i Zgjedhjeve i cili thotë 23074 zgjedhës, dakord?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

Për konsum publik apo nuk e di për çfarë u hodh një shifër dhe u tha janë 6157 persona që nuk kanë, nuk e di pse duhej thënë ajo, është problemi i KQZ-së, ta gjejë me veten. Gjithsesi ne pyetëm drejtoreshën nga del kjo shifër? Na shpjegoi një krehje statistike që ata bëjnë, nuk na ka interesuar ne ndonjëherë në proces, në këtë proces se kush del, se kush zgjedh ta rinovojë dhe kush zgjedh të mos e rinovojë dokumentin. Ajo është zgjidhje e tij. Dikush e lë fare nënshtetësinë, dikush ka nënshtetësi të dyfishtë, këto janë probleme të qytetarit. Në kuptueshmërinë time ditën e zgjedhjeve personi me një dokument të vlefshëm shkon dhe nëse ka interes voton. Paraqet dokumentin, është i vlefshëm, është i pavlefshëm. Tani mund të hyjmë e të bëjmë sofizma këtu, kemi mjaftueshëm njohuri të bëjmë lojë fjalësh dhe ta mbajmë debatin deri në darkë. Unë nuk lodhem, mund ta vazhdojmë deri në darkë, nuk do nxjerrim gjë. Do ruajmë seriozitetin e procesit!

**Z. L. Braho:** Nuk e kam për të bërë debate.

**Z. K. Bele:** Do të ruajmë seriozitetin e procesit!

**Z. L. Braho:** Tani ajo që...

**Z. K. Bele:** Ajo është lajthitje se nuk ka mundësi...

**Z. L. Braho:** dëgjo ..lajthitje pra..

**Z. K. Bele:**...kjo mua nuk më intereson fare.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. L. Braho:**...është lajthitje..

**Z. K. Bele:** Kemi shkelje, Ledio kemi një shkresë, hajde të ngatërrojmë administratën e KQZ-së, ta kapim me fjalë.

**Z. L. Braho:** Jo nuk kam ndërmend të ngatërroj asnjë, unë thjesht dua të dal këtu, në zgjedhjet e Kukësit a kanë votuar qytetarë me dokumenta të pavlefshme, me karta të skaduara, që ju kishte kaluar afati? Nuk e di në qoftë se na jep dot përgjigje KQZ-ja për këtë.

**Z. K. Bele:** S'jemi duke bërë analizën e zgjedhjeve të Kukësit.

**Z. L. Braho:** Këtu është parimi i sigurisë juridike, në qoftë se...Sepse kur janë zgjedhje të përgjithshme, gjithmonë janë shtyrë afatet, me akt normativ, zgjedhjet e Kukësit nuk janë shtyrë, por duam të dimë a është votuar atje me dokumente të skaduara apo jo? Ka qenë ky problem apo s'ka qenë ky problem?

**Z. K. Bele:** Ne jemi në një proces...

**Z. L. Braho:** ...sepse nuk mundet që për një bashki specifike, për problematika specifike duhet të mbahet një standard, nuk e di a mund ta kemi këtë informacion, pastaj është çështje tjetër...

**Z. K. Bele:** Nuk jemi në Komisionin e Ligjeve që diskutojmë çfarë legjislacioni duhet ndryshuar për këto çështje. Kemi një proces administrativ, kemi një debat për provën. Mbyllim debatin për provat dhe vazhdojmë. Se nuk është serioze kjo

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

që të hapim këto diskutime. Nga pala është parashtruar dhe në nivel pretendimi, moskryerja, moszgjatja sipas tyre të vlefshmërisë së dokumenteve, në disa zgjedhje është bërë disa zgjedhje nuk është bërë. Kjo është bisedë tjetër, mbyllim diskutimin për këtë. Për çfarë kemi kërkesa? Nuk mendoj që është serioze, të vazhdojmë procesin ku jemi, pastaj për Kukësin apo për zgjedhjet e pjeshme në bashki të tjera nuk i vlen këtij procesi.

**Z. L. Braho:** Nuk është çështje serioziteti, këtë e vlerësojnë palët por ajo që tani meqenëse po kërkohen ca prova dhe ne patjetër do të marrim një vendim ashtu si do vendosim por duhet të kuptojmë se çfarë del nga ato prova, që dhe ne të dimë: a t'i kërkojmë a nuk do t'i kërkojmë? Po s'kuptuam shifrat, se si kanë funksionuar shifrat nuk arrijmë dot që të themi a kanë vlerë ato regjistra apo nuk kanë vlerë ato regjistra për procesin. Kjo është e gjitha nuk ka asnjë natyrë tjetër.

**Z. K. Bele:** Cili është propozimi?

**Z. L. Braho:** Jo nuk kam ndonjë propozim, thjesht doja të kuptoja këtë se shifra më dukej e pakuptimtë dhe doli që aq qenka shifra, 52 himariotë kanë pasaportë, pjesa tjetër pastaj është çështje vendimmarrje.

**Z. E. Saliq, përfaqësues i PS:** Duhet ta verifikojë shifrën se këtu po flet një zyrtar, kjo me 52 po do ato statistikat që kanë bërë duhet të na i sqarojë me shkrim këtu, se 52-shi nuk ekziston.

**Z. K. Bele:** Unë refuzoj ta...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Unë e quaj një lapsus të administratës ose lapsus i kompjuterit, ose lapsus nga shkak i lodhjes. Nuk ekziston, që s'paskan 22000 paskan ID dhe 22 pasaportë, nuk ekziston fare. Po, këtu u tha që nuk ka dokument zyrtar, thjesht statistika, statistikat do të thotë që dhe aritmetikën këtu në KQZ e bëjnë gabim, del arimetika ndonjëherë gabim këtu! Ta verifikojnë atë shifrën nga e nxorën, edhe pse doli? Megjithatë unë për procedurë kërkoj që të vazhdojë procesi administrativ, palët s'janë dëgjuar akoma. Të dëgjohej palët, pastaj të diskutohet në bazë të procesit, mbas parashtrimeve diskutohet dhe për provat e reja. Besoj ndihmën palës ia dhatë provat, duhet të vijë me prova këtu, u bë proces paraprak për provat, tani vijë të bëjë parashtrimet.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Në vijim të asaj që tha përfaqësuesi i Partisë Socialiste dhe nga gjithë ky debat doli rishtas tani nga provat e reja që na u vunë në dispozicion pak minuta përpara. Kemi dy gjëra, dy elementë që duhet t'i theksojmë. E para rezulton 52 apo 53 sipas këtij informacioni që na është dhënë, 52 apo 53 e quajtet janë me pasaporta të vlefshme, në Bashkinë e Himarës nga mbi 23. Kjo ndoshta është një indicie nga ato që na u thanë, ku i keni indiciet? Ja ku janë dhe indiciet. Ne duam ta lidhim dhe këtë me atë informacionin tjetër të kartave që janë apo pasaportave që janë të vlefshme, ndërkohë Gjendja Civile apo PEI, apo pak rëndësi ka kush i ka bërë, del sikur personi i ka të pavlefshme ato dokumenta dhe mund të jetë penguar të votojë, pra kemi të paktën disa raste këtu që janë konkrete, te dokumentacioni që të gjithë e kemi tani në dispozicion. Kemi dy indicie të forta dhe nuk dimë se sa mund të jenë të tjera, besoj se sa KQZ-ja nuk e di sa raste të tilla të tjera. Çfarë po kërkojmë? Ashtu sikundër e tha dhe kolegu, le të na vihen në dispozicion këto prova. E ripërsëris dhe njëherë kërkojmë marrjen e provës nga KAS-i tek kutitë e materialeve zgjedhore për ato dy elementë që ne

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

kërkuam, pikën 3 dhe pikën 4, kopje të regjistrave të posaçëm, kopje të procesverbaleve etj., etj., sipas kërkesës sonë dhe pa marrë këto unë gjykoj se nuk mund të vijojmë debatin më tutje. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Kam një pyetje për administratën ju lutem. Në rastin e një vendimi eventual për të administruar këto prova, pra procesverbale, regjistra në kutitë e materialeve zgjedhore sa kohë ju duhet efektivisht që t'i kemi? Që të kemi nga një kopje për secilën?

**Znj. D. Alimemeti:** Do të duhet kohë për të marrë kutitë e materialeve zgjedhore njëherë.

**Z. K. Bele:** Ku ndodhen?

**Znj. D. Alimemeti:** Janë në Lundër. Nuk kemi njerëz, kështu që nesër mund të organizohemi sepse janë me leje. Nesër organizojmë punën që në mëngjes, rreth orës 10.

**Z. E. Çefa:** Pra, nesër mund të jenë gati këto? Mund të merren procesverbalet?

**Z. E. Meta:** Me ardhjen e materialeve, në KQZ, do të bëhet leximi, po e shpjegoj si procedurë, do të bëhet leximi i kodeve të sigurisë për çdo qendër votimi, do të evidentohet rast pas rasti dokumenti përkatës, pra le të themi 3 orë.

**Z. E. Lako:** Zoti relator unë prapë nuk jam i qartë se për çfarë kërkohet marrja e këtyre materialeve, domethënë nuk jam i qartë pas gjithë këtij debati pse pala

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

ankuese i kërkon këto dhe çfarë do gjejë, kanë lidhje me procesin. Se deri tani po bëjmë një debat për gjëra që nuk kanë lidhje me këtë çështje. Domethënë çfarë do kërkojmë ne duke hapur këto materiale, të nxjerrim çfarë?

**Z. V. Dule:** Ju faleminderit që na jepni dhe njëherë mundësinë, jemi pikërisht në momentin që ka fakte dhe indicie të cënimit të procesit dhe aty brenda pikërisht do të konstatojmë përmasën e cënimit të këtij procesi. Pa ato materiale është e pamundur që të hamendësojmë dimensionin real të pengimit të padrejtë të ushtrimit të së drejtës së votës ndaj, të një numri qytetarësh, po në të njëjtën kohë edhe zbatimin e standardeve të dyfishta për qytetarë të tjerë në të njëjtën situatë.

**Z. E. Lako:** Jo për replikë po meqë të gjithë kemi eksperiencë me procesin zgjedhor, debati duhet shqyrtuar dhe duhet fokusuar në lidhje me çështjet ligjore që kanë të bëjnë me procesin dhe me ato çfarë ju pretendoni, pra për të mos ta bërë si çështje të politizuar apo mbi fjalë të mëdha po mbi fjalë dhe mbi situata që përcakton ligji dhe objekti i ankimit. Pra, konkretisht te pyetja çfarë pretendoni ju që do të gjeni në këto dokumente që kërkonti të merrni që nëse e njihni procesin zgjedhor, të gjithë ato dokumente janë dokumente që i ka administruar komisioni i qendrës së votimit dhe KZAZ-ja dhe një kopje të çdo dokumenti e ka çdo forcë politike dhe e ka çdo anëtar i KQV-së, edhe nga praktika e zgjedhjeve edhe nga ajo çfarë ju keni deklaruar këtu që keni një pjesë të mirë të dokumenteve. Pra cili është dokumenti apo gjëja konkrete që ju pretendoni të merrni që i shërben këtij procesi? Pa i hyrë çfarë keni konstatuar ju që është cënuar procesi, çdo njeri ka të drejtën e vet që të pretendojë dhe të mendojë për aq... Ligjërisht cila është, pra ku e mbështesni shkeljen ligjore?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*


**Z. V. Dule:** Siç e thatë edhe ju kemi një pjesë të mirë po tërësinë e dokumentacionit, jo çdo parti jo çdo përfaqësues me tërësinë e dokumentacionit që gjendet aty. Kemi një pjesë të mirë të dokumentacionit dhe me këtë pjesë të mirë të dokumentacionit ju kemi sjellë fakte dhe prova dhe në pjesën tjetër të dokumentacionit që kërkojmë të kemi akses duam të provojmë pikërisht përmasën e këtij fenomeni, i cili si pasojë do të ketë pavlefshmërinë e procesit.

**Z. K. Bele:** Cili është fenomeni? Se ne po pyesim për të njëjtën pikë, shkelja ligjore, pra ku u mor ky dokumentacion, çfarë do të provojë, që qytetarët me ID, në një masë të caktuar qytetarët ID-ja e të cilëve nuk ishte e vlefshme nuk kanë votuar? Ky është? Numrin e këtyre qytetarëve? Duhet cituar shkelja ligjore.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Pa dashur që ta bëjmë debatin e provave që tani, unë e shpreha dhe më herët që ajo që duam të evidentojmë nga këto prova është jo vetëm përmasat se ku janë shkeljet dhe sa janë në mënyrë kuantitative sepse pikërisht në lidhje me shifrat do të flasim, për të vënë në diskutim rezultatin dhe diferencën midis dy kandidatëve për të arritur te pavlefshmëria atë që ne synojmë dhe përsëritja e zgjedhjeve si pasojë e saj. Duam të shohim gjithashtu sa është në realitet sepse ka pasur patjetër shkelje të barazisë së votës, shkeljen e barazisë së qytetarëve në të drejtën e tyre, cënimin e sigurisë juridike. Ajo që u tha, qytetarë me karta të vlefshme që janë penguar të votojnë, ka tjerë me karta të rinovuara në minutë të fundit që janë lejuar të votojnë, e me radhë. Megjithatë unë...

**Z. K. Bele:** Po pra, po ku bazohet z. Nuri? Se ne...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koulicionit BF:** Sollëm dhe shembuj.

**Z. K. Bele:** ...ne kemi praktikë të caktuar, duhet të..do vijnë prapë zgjedhjet, janë 4000 e ca qendra votimi, nëse ne ecim me praktikë që çdo kandidat për deputet apo në çdo rast ku ka gjithmonë dikush është fitues dikush është ankues. Nëse ne do ecim me praktikë që të marrim çdo kuti qendre votimi sepse do gjejmë aty shkelje, kjo nuk është ... E para nuk është ligjore dhe nuk është as në terma praktikë do të sjellë zvarritje të procesit. Po, është në ligj mekanizmi për të hapur dhe për të kërkuar prova por kur kjo lidhet me një shkelje të caktuar të pretenduar. Ne sot po kërkojmë të marrim, ju po kërkonit të merrni materiale zgjedhore për të provuar sipas jush një numër të caktuar shtetasish, të cilët kanë pasur dokument të skaduar dhe s'janë lejuar të votojnë por thoni ju mund të ketë dhe nga këta që e kanë pasur të skaduar dhe janë lejuar të votojnë. Kjo është...se është përdor dhe herë tjetër.. para kësaj trupe i njëjti argument dhe është mbajtur i njëjti qëndrim nga anëtarë të caktuar këtu, kjo është të bësh atë që quhet "fishing expedition", ne nuk do dalim të kërkojmë prova, nuk është ky qëllimi ynë dhe nuk është ky qëllimi i këtij procesit dhe do duhet të tregojmë çfarë provon shkeljen konkrete. Megjithatë ky është qëndrimi im personal, ju mund të mbani, keni të drejtën tuaj ta...Këtë të fundit sepse u zgjatëm...

**Z. E. Salianji, përfaqësuesi i PS:** E bëtë gjithë këtë debat. Realisht, unë e thashë që në fillim ne duhet të kishim filluar me parashtrimet pastaj në qoftë se pala kishte prova të diskutonim provat, në qoftë se kishte prova të merreshin provat. Megjithatë u kapërcyen, i mori provat, por u pa nga gjithë ky shqyrtim i provave që asnjë shkelje ligjore e asnjë shkelje të evidentuar, të palëve të cilët kanë qenë në shumicën e procesit nuk u soll para jush. Në qoftë se nuk janë këto atëherë do

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

hamendësojnë palët që ka logjika dhe aritmetika. Kalojmë te aritmetika, nëpërmjet logjikës, duke parë sa kanë votuar, pra presupozohet se këta 6000 ishin me karta kanë votuar në një qendër votimi dhe nuk kanë votuar, atëherë ne do të shikojmë sa kanë votuar në Himarë në tre palë zgjedhje. Në 2021 kanë votuar 5882, në 2023 kanë votuar 7821, në 2024 kanë votuar 8692, pra një mijë më shumë. Pra, që do të thotë me aritmetikë dhe me logjikë, mospasja e kartave valide të disa personave, të cilët nuk dinë ku janë, thjesht ne po i kërkojmë se ata nuk janë, nuk kanë qenë as në 2021, as në 2023, as në 2024. Është e vërtetuar me dokumenta nga KQZ-ja të nxjerra nga sistemi, të cilët në këto zgjedhje kanë votuar më shumë, në qoftë se do ishim përballë faktit që nga 7800 do kishin votuar 2000 atëherë ka një argument logjik, jo ligjor që të thoshim hajde t'i hapim kutitë se mund të gjejmë 4000 persona që kanë votuar në qendrën e votimit, janë mbajtur shënim në libër protokolli dhe ne ta konstatojmë, jo si shkelje, se ligji thotë që po nuk ke kartë të vlefshme nuk voton, po thjesht t'iu mbushim mendjen, në mënyrë statistikore, në këto zgjedhje personat kanë votuar me kartë. Nuk e di në ç'vend të Evropës, në Itali a Greqi që të vesh me një kartë identiteti, që nuk e ke të rregullt dhe të kërkosh të votosh. Por nuk ka qenë ky problemi në këto zgjedhje, ne kemi rritjen e votuesve, po ta shohësh me punë logjike, më të lartë, nuk ka ky problem, në ato kuti që do hapin se ju jeni institucion KAS-i, nuk jeni kafene që t'i hapim, të rrinë... Për mua hapini, hapini kutitë por para se të hapni kutitë shikoni sa kanë votuar. Çfarë kanë ato kuti? Por s'mund të tallesh me institucionin, kjo s'mund të hapim kutitë që hajde hapim dhe këtë, gjendet një gjë tjetër hajde shikojmë atje të prova. Te prova shkohet o me prova shkresore nga komisionerët e vet ose nga KQZ-ja sa është numri i pjesëmarrësve, pra pretendohet që është 6000 pa votuar presupozohet që kanë votuar 1000 më shumë në dy palë zgjedhje, çfarë do kërkojnë, çfarë do gjejnë aty? Prandaj dhe ligjërisht nuk ekziston problemi, zero. Zero problem ligjor dhe

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

aritmetikisht zero dhe të dyja bashkë. Unë këtë e kam për ju të KAS-it se pala ka të drejtë të kërkojë çfarë të dojë, por dhe logjikisht nuk ke çfarë kërkon. Po keni kohë hapini kutitë, madje shkoni dhe vetë atje meqë s'kanë nëpunës këta! Hapini, numërojini, shikojini! Por librat i keni bosh se ta thotë vetë statistika. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Duke qenë se kemi një situatë diskutimi midis nesh, në momentin e marrjes së provave, për procedurë, pra qëndrimin tuaj të fundit ne e morëm, ju kërkonim përveç këtyre dokumentave që u vunë në dispozicion, për pikën 3 dhe 4 katër ju kërkonim nga dy anëtarë të KAS-it, të disponojmë, nga KAS-i, në tërësi, nga 4 po 5 anëtarë që të disponojmë. Ne po mbajmë këtë qëndrim në seancë publike, unë dhe z. Lako. Nuk e di z. Rusmali nëse ka ndonjë qëndrim?

**Z. I. Rusmali:** Në qoftë se mund të ndërhyj një moment?

**Z. K. Bele:** Po të dëgjojmë, po.

**Z. I. Rusmali:** Së pari ka një mënyrë teknike për të vazhduar me procesin, drejt suksesit të tij sepse sukcesi i procesit është mbyllja e shqyrtimit me një vendimmarrje, cilado qoftë ajo dhe për të marrë në konsideratë të gjitha meraqet e palës ankuese, duhet të kuptojmë një gjë, barrën e provës e ka pala ankuese, pala që vë në lëvizje procesin dhe nuk e shkarkon dot tek institucioni, tek KAS-i. Kjo jo për shkak se KAS-i bezdiset nga shqyrtimi i çështjes në tërësi dhe kërkimi i provave, po për shkak se provat janë elementë, dhe ne këtë e kemi thënë me dhjetra herë, provat janë një element i domosdoshëm, më shumë i procesit ankimor, i cili i paraprin ngritjes së pretendimeve. Mua më vjen keq të dëgjoj nga pala ankuese këtu që thotë që ne kemi indicie po për ta kuantifikuar sa është dëmi duhet të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

shqyrtojmë çfarë ka brenda në kuti. Nuk është kjo rruga. Palët prandaj janë pjesë e procesit, prandaj kanë instrumentat, duart etyre në proces, prandaj kanë njerëzit e tyre që jo vetëm provat i mbledhin në proces por edhe kuantifikimin ta bëjnë përpara sa të ngrenë pretendimet. Nuk është me hajt po provojmë, nuk është tafti-bafti kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve. Ta provojmë njëherë se mbase del djalë, ta provojmë se ku i dihet mbase del vajzë! Nuk është kjo rruga! Rruga është që pala, që unë s'e di me siguri, me siguri absolute sa zgjedhës kanë shkuar për të votuar në 4 gusht në Bashkinë e Himarës dhe janë penguar që të votojnë, në kundërshtim me ligjin ose sa njerëz pa të drejtë votimi kanë shkuar të votojnë në Bashkinë e Himarës dhe janë lejuar të votojnë në kundërshtim me ligjin. Ky është argument pavlefshmërie dhe këtë gjë pala ankuese duhet ta dijë paraprakisht, përpara se të ngrenë pretendimin. Historia kemi një indicie që na kanë ardhur shumë veta po ne që ta marrim vesh sa janë hajde hapim kutitë, nuk është rruga e përshtashme. Megjithatë, unë e kuptoj se çështja është e lidhur me emocionet por megjithatë rruga besoj e kompromisit është shumë e lehtë. KQZ-ja ka vënë në dispozicion atë pjesë dokumentacioni që është kërkuar që ajo e disponon. KQZ-ja nuk prodhon dot prova, KQZ-ja servir prova, pra çdo kërkesë që KQZ-ja të investigojë dhe të hartojë raporte dhe të na i paraqisë nuk është e ligjshme dhe ne e kemi marrë një vendim të tillë dhjetra herë. Nuk mund t'i kërkojmë institucionit që të na prodhojë prova, por mund t'i kërkojmë të na vërë në dispozicion provat që disponon. Tani për ta çuar përpara procesin, nisur nga provat që disponon KQZ-ja, që disponon pala ankuese, ne fillojmë shqyrtimin në themel të çështjes, pra të dëgjojmë pretendimet e palës ankuese ose pretendimet e palës së interesuar, t'i konfrontojmë këto pretendime me kuadrin ligjor..pra të shohim futen në kontekstin e pavlefshmërisë, i një kërkesë për pavlefshmëri apo janë, domethënë të thëna kështu në ajër dhe e dyta të shohim ne si KAS a e kanë, provat e servirura,

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

a e kompletojnë bindjen që këtu jemi përpara një shkelje, pavlefshmërie apo jo dhe në fund fare pastaj të gjykojmë a ka nevojë për të marrë prova shtesë në mënyrë në mbështetje ose në kundërshtim të pretendimit që na ndihmojmë ne që të krijojmë bindjen tonë përfundimtare lidhur me pretendimin. Ta nisim procesin, ët debatojmë pretendimet, të debatojmë argumentat e palëve dhe pastaj kemi gjithmonë mundësinë që të shtojmë në proces edhe kërkesa për prova shtesë që janë thelbësore. Se më duket se po kërkojmë, po shpërndahemi shumë, me gjëra që nuk janë thelbësore. Nuk ka asnjë rëndësi për një proces pavlefshmërie, ndjesë që kush do mendojë që po futem te themeli. Po në fakt nuk jam duke u futur te themeli, nuk ka asnjë rëndësi për një proces pavlefshmërie statistika sa persona në një njësi territoriale kanë dokumenta të vlefshme identifikimi apo sa nuk kanë. Për ne ka rëndësi sa persona kanë shkuar të votojnë në përputhje me ligjin dhe janë penguar dhe sa persona kanë shkuar të votojnë në kundërshtim me ligjin dhe janë lejuar. Kjo është lëndë pavlefshmërie! Të tjerat janë muhabetë në ajër, muhabetë pazari, po doni dhe kuriozitetë statistikore po s'e ndihmojnë procesin tonë. Kështu që në qoftë se kolegët janë dakord unë do sugjeroja që ta fillojmë me dëgjimin e pretendimeve pikë për pikë nga pala ankuese, të dëgjojmë pretendimet, kundërshtimet ose çfarë quan pala e interesuar dhe pastaj të marrim gjithë çështjet që formojnë shkak pavlefshmërie dhe t'i analizojmë mbi bazën, për sa i takon bazës provuese të tyre. Nuk e di a jeni dakord apo jo? Po unë këtë sugjeroj.

**Z. K. Bele:** Po, faleminderit!

**Z. V. Dule:** Po e parashikon procedura kisha një pyetje?

**Z. K. Bele:** Po.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. V. Dule:** Zgjedhjet e 4 gushtit në Himarë janë shpallur pas shpalljes së ndërprerjes së mandatit nga KQZ-ja të z.Beleri dhe janë shpallur në një kohë nga Presidenti i Republikës, në një kohë që nuk ka mbaruar afati i ankimimit të atij vendimi, që i takon Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Himarës, z. Beleri. Një proces që e kemi për ta diskutuar në vazhdimësi në KAS. Z. Rusmali mos ndihet në konflikt interesi dhe mban një qëndrim të tillë, në një kohë që është Këshilltari juridik i Presidentit të Republikës dhe ka qenë besoj një nga referuesit për shpalljen e zgjedhjeve duke shkelur të drejta kushtetuese?

**Z. K. Bele:** Z. Dule, kjo është një pyetje, ne po flasim për procesin...

**Z. V. Dule:** Pyetje e keqe?

**Z. K. Bele:** Jo, nuk kemi ardhur... Nëse kishit një pretendim lidhur me ndonjë nga anëtarët apo ndonjë shkak pavlefshmërie është praktikë e cila është...

**Z. V. Dule:** Po asnjëherë s'është vonë

**Z. K. Bele:** Po mirë në këtë fazë...

**Z. V. Dule:** ...procesi është dinamik..

**Z. I. Rusmali:** Zoti drejtues i seancës!

**Z. K. Bele:** Më fal, po.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. I. Rusmali:** Ndjesë, mund të jap përgjigje për këtë? Se kjo është domethënë, ky është devijim shumë larg çështje sonë. E para, unë personalisht, domethënë përtej faktit që raporti im me KAS-in dhe detyra ime funksionale në Presidencë nuk kanë asnjë lidhje me njëra-tjetrën, fare. Por unë mund ta siguroj z. Dule se përveç faktit që KAS-i nuk merret fare me atë çështje, në sensin që e trajton z. Dule por edhe për faktin, mund ta siguroj edhe për faktin se si këshilltar i Presidentit të Republikës, unë nuk kam pasur lidhje me atë procedurë. Kështu që mos të kërkojmë kot, mos të gërmojmë vend e pavend, mos gjejmë ndonjë kadavër dhe pastaj themi urra. Nuk ekziston çështja, le të përqëndrohemi te kjo, te tema e KAS-it sot. Se është temë shumë e rëndësishme, një kërkesë për pavlefshmërinë e zgjedhjeve është kërkesa më serioze që mund të behët në një proces zgjedhor, më e rëndësishmja, nuk ka diskutim domethënë dhe nuk ka çështje më madhore për një strukturë siç është KAS-i se sa të merret me shumë seriozitet dhe me themel me trajtimin e një kërkesë të tillë. Nuk ka nevojë të devijojmë dhe të shkojmë në drejtime të paditura. Është shumë e thjeshtë çështja, të dëgjojmë me vëmendje të gjitha pretendimet e z. Dule dhe z. Nuri. Që të gjitha me shumë vëmendje, t'i konfrontojmë ato me kuadrin ligjor për pavlefshmërinë, i cili është kuadri ligjor ekstremisht preciz, nuk lë hapësirë për ambiguitete, është shumë preciz, të verifikojmë gjithçka bazuar në prova dhe t'i japim hakun atij që i takon, z.Dule, në qoftë se z. Dule ka me vete ligjin dhe faktet, z. Nuri, në qoftë se z. Nuri ka me vete ligjin dhe faktet, po dhe z. Salianji në qoftë se ai ka me vete ligjin dhe faktet. Ne jemi arbitra në këtë proces, ne nuk jemi palë.

**Z. K. Bele:** Z. Nuri, nëse s'ka ndonjë gjë tjetër nga kolegët, unë në këtë fazë, ju janë vënë në dispozicion ato prova të kërkuara nga ana juaj e KQZ-së ato që kanë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

qenë të mundshme dhe që KQZ-ja mund të dispononte si të lilla. Duke qenë se ky është një proces administrativ, i cili midis të tjerave ka parimin e kontinuitetit dhe duke qenë se këto prova lidhen me faktet të njohura dhe lidhen dhe me ato çka ju keni ngritur në ankimin tuaj. Për të vazhduar procesin ju ftoj të bëni parashtrimet për çfarë kemi administruar deri tani dhe duke mbështetur dhe atë që tha z.Rusmali, nëse ka gjëra të tjera që mund të dalin apo që mund të lindin apo qëndrime që mund të mbahen nga kolegët gjatë procesit. Prosesi është i hapur dhe secili nga ne ka të drejtë që të shtojë apo të plotësojë, por në këtë moment mund të dëgjojmë çfarë keni për të thënë duke pasur parasysh që keni ankimin me shkrim dhe këto prova të cilat ju vënë në dispozicion.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po marr shkas dhe nga ajo që tha z. Rusmali, unë mendoj që procesi, përtej emrave konkretë, ka të bëjë me subjektet dhe unë përfaqësoj koalicionin “Bashkë Fitojmë” dhe jo personin tim në mënyrë individuale. Marr shkas dhe nga ajo që u tha si parantezë hyrëse se KQZ-ja servir prova, po është shumë e vërtetë, KQZ-ja duhet të na servirte provat dhe nuk e di pse KQZ-ja na i pati mbajtur provat dhe nuk na i dha derisa erdhëm këtu, ndonëse kërkesa jonë datonte që me 12 gusht, e protokolluar me 13 gusht. KQZ-ja në fillim të kësaj seance, administrata e KQZ-ja tha provat i kemi, një pjesë i kemi kopje dhe nuk na i vuri në dispozicion as një orë përpara seancës, as një ditë përpara seancës, na i vuri në dispozicion në çastin që rifilloi seanca, mbas ndërprerjes 45 minuta. Po është e vërtetë, KQZ-ja duhet të serviri, KQZ-ja nuk shpik dhe nuk sajton prova, absolutisht jemi dakord këtu. Provat janë në kutitë e materialeve zgjedhore, na thotë KQZ-ja sepse në fillim, më herët në këtë seancë na u tha nga përfaqësuesit e KQZ-së këtu prezent, që për pikën 3 i kishin këto prova. Më pas na thanë që dhe për treshin dhe për katrën, të dyja këto elementë, provat qenkan që ne

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

kërkojmë nuk i ka KQZ-ja, por qenkan në kutitë e materialeve zgjedhore. Ndaj dhe ne kërkuam që të na vihen në dispozicion ato prova aty ku janë. Janë materiale zgjedhore le të na vihen ato dhe e kërkuam shprehimisht mbi bazën e e nenit përkatës të Kodit Zgjedhor që ka lidhje me marrjen e provës nga ana e KAS-it. Për gjykim të gjithanshëm, të plotë, të këtij elementi. Nuk do na shërbejnë këto prova vetëm në KAS ato gjykoj do na shërbejnë dhe në Kolegj Zgjedhor eventualisht dhe pse jo në instanca të tjera, që mbrojnë të drejtat e njeriut. Megjithatë unë insistoj dhe këtu, unë do refuzoj të bëj parashtrimet e mia sepse kërkoj marrjen e një vendimi nga ana e KAS-it. Po apo jo? Do na vihen në dispozicion, do na lihet një kohë e mjaftueshme, të paktën dhe këto që na u dhanë, t'i studiojmë dhe t'i shqyrtojmë. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Praktikisht duke bërë një proces po quajmë në thonjëza “ndryshe”, ne i diskutuam zë për zë këto, pra ju këtu ato çfarë, dokumentat që u sollën përmbajnë ne i diskutuam dhe i debatuam dhe lexuam dhe pjesën nga përmbajtja e tyre. Megjithatë kërkesa është që të shprehemi lidhur me kërkesën tuaj për marrjen e provave nga kutia. Të konsultohemi me njëri-tjetrin.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Pra, e thatë dhe vetë që e bëtë seancë ndryshe, ajo çka tha z. Rusmali duhet të shqyrtohet nga ju dhe të vazhdojë procesi, duhet të vazhdojë parashtrimi, duhet ta dëgjojmë hallin njëherë çfarë ka. Mundet që me këto parashtrime s'ka nevojë fare për prova, mund të ketë pavlefshmëri. Nuk mundet që të bëjmë një proces në mënyrë mbrapsht dhe t'i thuhet institucionit që unë nuk bëj parashtrimet, ti e tërheq fare nga kërkesa, kjo është ajo që duhet t'i thoni ju tani. Pra ai do të bëjë parashtrimet ne duhet të... Prit tani... Jo, i gjithë procesi administrativ ka një logjikë dhe e tha dhe në Kodin Zgjedhor po ta shikoni

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

se si zhvillohet procesi administrativ, vazhdohet me parashtrimet e palëve. Parashtrimet e palëve ju duhet ta na dëgjoni ne. Më jep mua të drejtën për të dëgjuar, mos e dëgjoni këtë, mirë unë e kam lexuar kërkesën ankimore dhe unë për kërkesën ankimore do të bëj prapësimet e mia. Faza që bëhen prapësimet e mia është në këtë fazë. Provat, pavarësisht se u morën provat para por në qoftë se pala nuk vazhdon me parashtrimet unë këtë e marr si heqje dorë nga kërkesa dhe vazhdimisht më jepni mua radhën të përgjigjem unë për prapësime.

**Z. E. Çefu:** Unë shkurtimisht dhe unë për procedurë z. Nuri, pra do t'ju ftoja që ta shohim pak nga pikëpamja më praktike gjënë dhe mua personalisht, propozimi i z.Rusmali nuk m'u duk aspak i keq dhe përkundrazi do na ndihmojë ne. Ne po diskutojmë për një provë që do na çojë diku, ndërkohë që zyrtarisht ne akoma s'kemi dëgjuar, nuk ju kemi dëgjuar për themelin. A më kupton? Logjika është kjo, unë të dëgjoj ty për themelin, me rezerva në ato pika që ti mendon që kërkimi i provës mund ta ilustrojë dhe më mirë fenomenin. Pra, miqësisht, krejtësisht miqësisht nuk shoh që ka arsye për të krijuar konflikte kur nuk ka nevojë fare. Ne jemi në një proces administrativ, e fillojmë nga A-ja, nuk shoh ndonjë gjë të keqe në këtë pikë, ju dëgjojmë. Në vendet ku ju mendoni që për këtë pikë ne duhet të parashtrijmë rezerva, që të paraqesim argumente shtesë pasi të kemi parë dhe provat e tjera që kemi kërkuar, nuk mendoj që ka ndonjë gjë të keqe. Megjithatë në qoftë se ju prapë nuk jeni në gjendje për shkak se provat që i kërkuat me 12 jua dhanë sot, atëherë kjo e ndryshon situatën totalisht. Pra në qoftë se ju doni ta rishikoni dhe njëherë formatin e ankimit që keni bërë duke e ilustruar me këto prova që morët sot jam plotësisht dakord se aty nuk mund të them unë mësoje tani përmendësh këtë dhe ma thuaj pas 10 minutave se aty pastaj është krejtësisht e drejta juaj. Po në parim nuk mendoj që ishte diçka tendencioze dhe sugjerimi i

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

kolegut Rusmali, përkundrazi unë mendoj që punët ashtu duhet të fillojnë, pra me një rend të caktuar, logjik dhe procedural, për të dalë pastaj te konkluzionet e tjera. Megjithatë, ju thashë nuk ka problem, në qoftë se ju për këtë shkak nuk jeni në gjendje, pa i lexuar mirë këto prova që ju dhanë sot që të na filloni të na ilustroni ankimet, atëherë dakord. Ne po tërhiqemi, po diskutojmë nja dy gjëra dhe po vendosim se çfarë do bëjmë.

**Z. K. Bele:** Mos ta bëjmë diskutim. Këtu ka një gjë të veçantë, duke qenë se ishim në mes të gushtit dhe u kërkua marrja e disa dokumentave dhe për shkak edhe të pamundësisë administrative, pra njerëzit, administrata ishte në një muaj të gushtit, mes korrikut dhe gushtit me menaxhimin e procesit zgjedhor. Ne dhamë një kohë të caktuar për të marrë këto prova. Sigurisht këto kanë qenë gati, menaxhim ose keqmenaxhim administrativ, sepse këto që ne morëm sot ishin gati dhe ata duhet t'i kishin marrë më përpara. Duke thënë këtë këtu nuk ka ndonjë gjë që ju nuk u diskutua dhe ishte e panjohur për palët, përveç atyre që u thanë që s'kanë lidhje me KQZ-në. Ne kemi një moment debati, ju merrni kohën tuaj për të bërë prapësime shitesë, por kërkesën tuaj ankimore të cilën e keni bazuar mbi ato prova që kishit dhe njohje të procesit ku keni qenë palë në proces, është e logjikshme në këtë moment të parashtroni dhe njëherë, shkurtimisht në mënyrë të përmbledhur çfarë ju kërkoni, shtoni elementë nëse mundeni, në dritën e këtyre provave, të dëgjojmë prapësimet e palës tjetër dhe të vazhdojmë procesin, kjo është kërkesa, sugjerimi që u bë nga ana jonë. Nuk do jetë ndonjë hata e madhe, ne e shtyjmë dhe një ditë dhe dy ditë, një javë, këtë punë kemi. Po duhet të jemi të arsyeshëm për mënyrën si funksionon procesi.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

**Z. V. Dule:** Natyrisht që nuk është një proces që ndikohet nga një orë, nga një ditë apo nga një javë. Ne na intereson që ajo që do bëhet të bëhet e saktë dhe e qartë. Ne nga ana jonë diçka që kemi kërkuar 20, 10 ditë para e kemi marrë para gjysëm ore, treçerek ore. Sigurisht që çdo njeri nuk e di, ju si po operoni, kemi nevojë për nevojën clementare që t'i lexojmë, t'i vëmë në një rend logjik argumentat dhe e dyta presim një përgjigje që është para kësaj të dytës, kërkojmë që të na jepen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas kërkesës së datës 12, 13 gusht, që nuk na janë vënë në dispozicion deri tani. Ka mundësi të kemi një vendim, do të na vihen në dispozicion apo nuk do të na vihen në dispozicion, pavarësisht ecurisë së procesit.

**Z. K. Bele:** Edhe njëherë ju shpjegojmë që ajo kërkesë shtrohet gjatë procesit, megjithatë, nuk është paraprake se nuk hapen kutitë në fillim të procesit, megjithatë për shkak të një mirësjellje dhe dashamirësie tonën për të ndihmuar procesin, u operua në një mënyrë sui generis, që jua shpjegova sepse edhe këto kërkesa do të bëheshin gjatë seancës jo para seancës. Duhej filluar me parashtrimet, duke thënë këtë procesi në këtë fazë është zhvilluar konform atyre parashikimeve të Kodit, nga KQZ-ja u morën të gjitha ato dokumentacione dhe prova që KQZ-ja mundet të sillte dhe dispononte, mund të parashtronte, ngelet kërkesa juaj për marrjen e materialeve të kutive të cilat gjenden në kutitë e materialeve zgjedhore, për të cilat ka një procedurë të caktuar ligjore, të cilën ne ju shpjegojmë që mund ta ngrini dhe duhet ta ngrini gjatë parashtrimeve. Ne po marrim një shkëputje për pak minuta për ta diskutuar, mbase dhe ne nuk jemi ndodhur ndonjëherë në këtë lloj kërkesë në këtë fazë të procesit, në vlerësimin tim nuk është ligjore, gjithsesi procesi është i tillë, palët bëjnë kërkesa ne shprehemi. Kështu që po e ndërpresim seancën për pak minuta.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.08.2024*

*Rifillon seanca*

*Ora, 15:22*

**Z. K. Bele:** Riçelim seancën, mbasi u konsultuam lidhur me kërkesën tuaj për të marrë kohë lidhur me ato që ju i morët nga KQZ-ja, KAS vendosi që të shtyjë seancën për ditën e nesërme në orën 11.00, me qëllim që ju të keni kohë për të bërë parashtrimet në lidhje me provat që morët nga KQZ-ja sot dhe në vazhdim të procesit, eventualisht po shprehemi lidhur me kërkesën tuaj për marrjen e atyre provave shtesë për pikën 3 dhe 4, nëse ju do i qëndroni asaj kërkesë dhe nëse do të ketë arsye të lidhura me to, qëndrimin tuaj dhe të palës tjetër lidhur me këtë. Pra, duke qenë se sot ezauroam momentin procedural të marrjes së provave të cilat ishin të mundura nga KQZ dhe duke qenë se ju kërkuat kohë për t'u njohur dhe për të plotësuar qëndrimin tuaj mbi ato prova, po e shtyjme procesin për nesër në orën 11.00, për të vazhduar ku e lamë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

